PËR MËSUESIN/EN

dukagjini
shtëpia botuese publishing house

Valdete Bicurri, Edi Rexha-Dula,
Valon Bajraktari

# EDUKATË FIZIKE, SPORTET DHE SHËNDETI

2

Për klasën e dytë të arsimit fillor

# PËRMBAJTJA


Udhërrëfyes ........ 5
Hyrje ........ 7
Planifikimi vjetor ........ 15
Plani dymujor: shtator—tetor ........ 16
Plani dymujor: nëntor—dhjetor ........ 18
Plani tremujor: janar—shkurt—mars ........ 20
Plani tremujor: prill—maj—qershor ........ 22
Mësimi 1: Matjet antropometrike ........ 24
Mësimi 2: “Shamia e humbur” ........ 26
Mësimi 3: “Pasqyra” ........ 28
Mësimi 4: Dhëmbët ........ 30
Mësimi 5: Simptomat e gripit ........ 32
Mësimi 6: Vrapojmë që të jemi të shëndetshëm ........ 34
Mësimi 7: Vrapime nga pozita të ndryshme ........ 36
Mësimi 8: Drejtqëndrimi - balancimi ........ 38
Mësimi 9: Ushtrime formimi - imitimi i kafshëve ........ 40
Mësimi 10: Ecja e drejtë në traun e ulët dhe në vija të caktuara ........ 42
Mësimi 11: Ecja me duar dhe me këmbë sipas kombinimit ........ 44
Mësimi 12: Dëgjo rregullat! ........ 46
Mësimi 13: “Shishet e rrëzuara” ........ 48
Mësimi 14: Cili është grupi më i shpejtë? ........ 50
Mësimi 15: “Lexo dhe vepro” ........ 52
Mësimi 16: Pasimi i topit nga pozita të ndryshme ........ 54
Mësimi 17: Hedhja (shtytja) e topit me një dorë ........ 56
Mësimi 18: Pasimi i topit me këmbë - Gjuajtja e topit me këmbë ........ 58
Mësimi 19: “Të lëvizim me ritëm” ........ 60
Mësimi 20: “Gjej hapësirën tënde” ........ 62
Mësimi 21: “Kapja e shkopit” ........ 64
Mësimi 22: “Bartja e rrethit duke u rrokullisur” ........ 66
Mësimi 23: Rrotullimi anash i shtrirë ........ 68
Mësimi 24: Kapërdimi para ........ 70
Mësimi 25: Vrapimi me pengesa ........ 72
Mësimi 26: “Bredhi i Vitit të Ri” ........ 74
Mësimi 27: Si të çlodhemi? ........ 76
Mësimi 28: Si të vishem gjatë aktivitetit fizik dhe pas tij? ........ 78
Mësimi 29: Higjiena personale pas aktivitetit fizik ........ 80
Mësimi 30: “Poligoni” ........ 82
Mësimi 31: Koordinimi i lëvizjeve ........ 84
Mësimi 32: Vrapim 2x20 m ........ 86
Mësimi 33: Tërheqja e shokut ........ 88
Mësimi 34: “Ecja në kolonë” ........ 90
Mësimi 35: “Orientimi” ........ 92
Mësimi 36: Gjuajtja e topit në kosh ........ 94
Mësimi 37: Kërcimi me litar ........ 96
Mësimi 38: “Zgjidh ngjyrat” ........ 98
Mësimi 39: Kërcimi i pengesave ........ 100

Mësimi 40: Grumbullimi i koneve ........ 102
Mësimi 41: Vrapim me matje të kohës ........ 104
Mësimi 42: Rreshtimi ........ 106
Mësimi 43: Ushtrime të forcës ........ 108
Mësimi 44: Pasimi i topit me gishta - Pasimi i topit për tokë ........ 110
Mësimi 45: Pasimi i topit me një dorë ........ 112
Mësimi 46: Udhëheqja e topit me këmbë ........ 114
Mësimi 47: "Kalimi i topit në tunel" ........ 116
Mësimi 48: "Lëvizja me litar" ........ 118
Mësimi 49: "Ndërro ngjyrën" ........ 120
Mësimi 50: "Rrëzo topat" ........ 122
Mësimi 51: "X-O" ........ 124
Mësimi 52: "Shamia" ........ 126
Mësimi 53: "Zogjtë dhe dhelprat" ........ 128
Mësimi 54: "Bletët, grerëzat dhe mjalti" ........ 130
Mësimi 55: "Kalojmë nëpër rrathë" ........ 132
Mësimi 56: "Helikopteri i caktuar" ........ 134
Mësimi 57: "Formojmë numër" ........ 136
Mësimi 58: "Kush është më i sakti?" ........ 138
Mësimi 59: "Mbaje në mend" ........ 140
Mësimi 60: "Fusha e minuar" ........ 142
Mësimi 61: "Fishekzjarri" ........ 144
Mësimi 62: "Stafeta e pasuar" ........ 146
Mësimi 63: "Qëllo në shenjë" ........ 148
Mësimi 64: Higjiena para dhe pas ushqim it ........ 150
Mësimi 65: Cili është ushqimi i shëndetshëm? ........ 152
Mësimi 66: Si i pastrojmë frutat dhe perimet? ........ 154
Mësimi 67: Vlerat e frutave ........ 156
Mësimi 68: Rëndësia e barnave ........ 158
Mësimi 69: Rreziku nga barnat ........ 160
Mësimi 70: Mjedisi i jashtëm ........ 162
Mësimi 71: Ta mbajmë mjedisin të pastër! ........ 164
Mësimi 72: Faktorët që ndikojnë në zhvillimin tim ........ 166
Mësimi 73: Mjedisi im i përshtatshëm ........ 168
Mësimi 74: Tetëkahore ........ 170

Të dashur mësues dhe mësuese,

Në duar keni librin tuaj, i hartuar për t'ju ardhur në ndihmë për zhvillimin e mësimit, mbështetur në metodologjitë më të përparuara bashkëkohore.

Sistemi arsimor në Kosovë ka kaluar nëpër vështirësi të ndryshme dhe në shkolla janë përdorur metoda tradicionale të mësimdhënies. Sot kemi mundësinë që arsimi t'i pajisë nxënësit me kompetencat që u nevojiten, për ta formësuar jetën e tyre dhe për të kontribuuar në shoqëri. Për ta gjetur mënyrën më të mirë dhe për ta realizuar këtë synim, shtëpia botuese "Dukagjini" ka nisur projektin për përfshirjen e metodologjive të mësimdhënies ndërvepruese në librat e mësuesve, i cili ka për qëllim t'ju ndihmojë të gjeni përgjigje për pyetjen themelore: "Çfarë metodologjie do të përdorni për të ndërtuar e krijuar dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që do t'u nevojiten nxënësve të Kosovës për ta formësuar të ardhmen e tyre?"

Integrimi në hapësirën arsimore të shekullit të 21-të kërkon, midis të tjerash, modernizimin e metodave ekzistuese të mësimdhënies dhe të të nxënit, futjen e veprimtarive bashkëkohore në mësim, që mundësojnë përgatitjen e një individi aktiv, të pavarur dhe të lirë, të pajisur me shprehi të të menduarit kritik, krijues, komunikues dhe bashkëpunues, i aftë për t'i përmbushur kërkesat e shoqërisë së sotme.

Cilësia e re e të nxënit dhe mësimdhënies përbën përparësi absolute për arsimin. Ju nuk jeni vetëm burime informacioni, por lipset të përdorni metoda dinamike të mësimdhënies, të quajtura edhe metoda mësimore ndërvepruese, të cilat përbëjnë elementet bazë të këtij modeli, për t'i motivuar nxënësit që të angazhohen më shumë në mësim.

Modeli i këtyre librave po përdoret për herë të parë në Kosovë dhe mësimet janë hartuar nga kolegët tuaj, me profesionalizëm, përkushtim dhe përgjegjësi maksimale.

# UDHËRRËFYES

## për konceptimin e mësimeve model

### Faqja në të majtë

Këto janë të dhëna identifikuese, të cilat orientojnë për mësimin.

Rezultatet e të nxënit të temës janë në koherencë me ato të fushës.

Mësimi synon që përmes rezultateve të të nxënit të kontribuojë në një ose disa prej kompetencave.

Rezultatet specifike të të nxënit janë ato mbi të cilat ndërtohet mësimi.

Janë zbërthim i rezultateve të të nxënit sipas niveleve të arritjes. Përcaktohen me nxënësit në klasë.




Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësuesin/en gjatë përgatitjes.

Të gjitha mjetet dhe materialet që ndihmojnë në konkretizim.

Zakonisht mësimi ka lidhje me lëndë dhe fusha të tjera, të cilat evidentohen.

Metodologjia e mësimit ndërtohet në hapa, të cilët mund të jenë tre ose edhe më shumë. Tri figurat jepen së bashku, çka sugjeron që mësimi duhet të ndërtohet mbi të mëparshmen, për të vijuar më pas me dije e shkathtësi të reja.

### Faqja në të djathtë

Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësuesin/en gjatë përgatitjes.

Në fund të mësimit bëhet vlerësimi formues i nxënësve për veprimtaritë e zhvilluara në mësim.

Për t`i përforcuar dijet dhe shkathtësitë, në fund të mësimit jepen detyra për t'u kryer në shtëpi.

Vetëreflektim dhe vetëvlerësim për orën mësimore në raport me arritjen e rezultateve të nxënësve.




Pas pjesës hyrëse, vijon hapi tjetër për pjesën kryesore të mësimit, ku, përmes përdorimit të teknikave të ndryshme, të nxënët bëhet më tërheqës dhe nxënësit bëhen aktivë, duke u përfshirë në veprimtari të ndryshme.

Veprimtaritë në këtë hap, a këta hapa të mësimit, udhëhiqen nga mësuesi/ja dhe nxënësit i kryejnë ato sipas udhëzimeve apo duke ndjekur modelin gjysmë të përgatitur.

Hapi i fundit është praktikë e pavarur ku nxënësit inkurajohen që t'i vazhdojnë veprimtaritë, por tashmë të pavarur, dhe inkurajohen duke u dhënë sugjerime kur është e nevojshme.

## Përshkrim i rubrikave kryesore të orës së mësimit

**Rezultatet e të nxënit të temës:** Janë hartuar mbi bazën e koncepteve të përgjithshme, të cilat janë pika referuese në përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore për lëndën dhe rezultateve të të nxënit për këtë temë. Në këtë rast mund të merren nga tabela e krahasimit të planeve dhe programeve ekzistuese me Kurrikulën Bërthamë, por edhe mund të hartohen vetë, mund të jenë një, dy a më shumë rezultate. Një rezultat i të nxënit të lëndës mësimore mund të shërbejë për një apo më shumë njësi mësimore, kjo varet nga përshkrimi i rezultatit të të nxënit dhe nga elementet përbërëse të tij.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** Zhvillimi i kompetencave, përkatësisht në rezultatet e tyre, bëhet përmes fushës kurrikulare, e cila kontribuon në arritjen e rezultateve të kompetencave. Të gjitha kompetencat kryesore të kurrikulës zbërthehen në rezultate të të nxënit. Ato janë pjesë e Kurrikulës Bërthamë dhe parashihen të përvetësohen nga nxënësit, me rastin e përfundimit të shkallës së kurrikulës.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** Shprehin kërkesat thelbësore të arritjes në fushën kurrikulare, drejt zotërimit të kompetencave kryesore, në përfundim të shkallës. Ato përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë të bëjë nxënësi në fund të shkallës a nivelit dhe shprehin një varg domenesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat. Vendosen rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare, vetëm ato që reflektohen në temën mësimore.

**Rezultatet e të nxënit:** Rezultatet specifike të të nxënit janë ato mbi të cilat ndërtohet ora e mësimit, të cilat përbëjnë detajimin e rezultateve të të nxënit të temës, e që janë në koherencë me ato të fushës së kurrikulës.

**Kriteret e vlerësimit/suksesit:** Janë zbërthim i rezultateve të të nxënit sipas niveleve të arritjes dhe sigurojnë vlerësim të drejtë për shkallën e zotërimit. Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Metodologjia dhe veprimtaritë me nxënës - hapat e zhvillimit të mësimit:** Meqenëse nxënësit e klasë së parë dhe të dytë mësojnë konceptet dhe shkathtësitë fillestare, në këtë fazë të zhvillimit, ata përparojnë në drejtim të zotërimit të tyre, por nuk i zotërojnë operacionet mendore, së këndejmi edhe të menduarit e tyre ëshë paraoperacional, kështu që mësimi kalon përmes hapave.

***Çfarë simbolizon modeli me tri pamje të ndryshme të ciklit të jetës së bimës së grurit?***



Mbillet një farë në një truall pjellor. Pasi është bërë puna themelore e fillimit, mësuesi/ja vazhdon dhe fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera.

Këto tri figura, jepen së bashku, njëra pas tjetrës, çka sugjeron se mësuesi duhet të ndërtojnë mësimin mbi të mëparshmen dhe të ketë parasysh se çfarë mund të vijojë. Cikli i jetës së grurit, nga fara në tokë, në bimë, e prapë në farë, sugjeron, gjithashtu, ciklin e vazhdueshëm të shkollimit, përmes mbështetjes në njohuritë ekzistuese, për të vazhduar më tej.

Në këto klasa, mësimi zhvillohet në hapa, të cilët, sipas lëndës dhe veçorisë, mund të jenë tre ose edhe më shumë, por gjithsesi mësimi do të ndjekë këtë ecuri.

**Hyrje:** Identifikohen njohuritë dhe shprehitë fillestare të nxënësve që të nxitet interesi i tyre për mësimin.
**Pjesa kryesore e mësimit:** Mësuesi/ja, përmes përdorimit të teknikave të ndryshme synon ta bëjë tërheqës të nxënit e mësimit, duke përdorur mjete të larmishme konkretizuese, figura, tabela, fotografi, video dhe të tjera.

**Praktikë e udhëhequr:** Veprimtaritë në këtë etapë të mësimit kërkojnë që të udhëhiqen nga mësuesi/ja dhe nxënësit i kryejnë ato sipas udhëzimeve a duke ndjekur modelin gjysmë të përgatitur.

**Praktikë e pavarur:** Nxënësit inkurajohen që të vazhdojnë veprimtaritë, por tashmë të pavarur dhe nxiten duke u dhënë sugjerime, kur është e nevojshme.

# HYRJE

**Konceptimi dhe ndërtimi i librit për mësuesin**

## EDUKATË FIZIKE, SPORTET DHE SHËNDETI 2

Fusha e kurrikulës *Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti* siguron që nxënësit të zhvillojnë njohuritë, të kuptuarit, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet për mirëqenien e tyre mendore, emocionale, sociale dhe fizike.

Kjo fushë i përgatit nxënësit për mundësitë, përgjegjësitë dhe aftësimin për jetë, si vlera kryesore për rritje dhe zhvillim cilësor individual dhe kolektiv. Kontributet edukative dhe formuese të edukimit fizik dhe të shëndetit të nxënësit, janë tashmë të gjithë të pranuara dhe kjo e bën një fushë të rëndësishme me ndikime të padiskutueshme në rritjen dhe zhvillimin e njeriut.

Fusha *Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti* do të ofrojë qasje të integruar të edukimit fizik me edukatën shëndetësore, gjatë gjithë viteve të shkollimit, deri në shkallën e gjashtë.

Mësuesi është i lirë të zgjedhë metodologjinë e punës, duke vlerësuar drejt kushtet, rrethanat, mjetet dhe mundësitë reale. Ai duhet të marrë parasysh mësimin e bazuar në arritjen e kompetencave, me nxënësin në qendër, gjithëpërfshirjen dhe mësimin e diferencuar, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënit si dhe mësimin e bazuar në projekte, i cili zhvillon shkathtësitë praktike të kërkuara në Kornizën Kurrikulare.

### Udhëzime metodologjike

Për realizimin e përmbajtjeve që përcaktohen në fushën *Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti* mund të përdoren metodat e ndryshme të punës me qëllim të arritjes e rezultateve të kompetencave, të cilat janë të përbashkëta për të gjitha fushat, përfshirë edhe këtë fushë. Në kuadër të kësaj, fokusi i mësuesit/es duhet të jetë në zbatimin e metodologjive, të cilat sigurojnë një mësimdhënie gjithëpërfshirëse për të gjithë nxënësit.

### Metodologjia ndërvepruese në mësimdhënie dhe të nxënët

Ky libër është hartuar për t'ju pajisur me metodologjinë ndërvepruese në ndërtimin e dijeve dhe formimin e shkathësive. Ai trajton temat mësimore në përputhje, me Kurrikulën Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës" (2016), si dhe me të gjitha dokumentet dhe udhëzimet administrative në fuqi, ku është mbështetur metodologjia me të gjithë elementet përbërëse duke filluar me kontributin në kompetencat kryesore dhe rezultatet e të nxënit të fushës, rezultatet specifike të të nxënit të njësisë mësimore, mjetet e punës, ecurinë metodologjike të orës së mësimit e deri te vlerësimi i nxënësve. Një nga risitë e këtij libri është se përmban edhe një rubrikë: *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore*. Qëllimi i kësaj rubrike është që t'ju ndihmojë të mbani shënime për punën tuaj në klasë, arritjet, por edhe mossuksesin, dhe më pas të reflektoni kur të bëni përsëritje, të kontrolloni dijet dhe të bëni vlerësimin e nxënësve, por edhe kur të zhvilloni mësimin një vit apo disa vjet më pas.

Në aspektin metodologjik të hartimit të modeleve orientuese për çdo orë mësimi, i është kushtuar kujdes i veçantë harmonizimit të të gjitha veprimtarive. Marrëdhëniet midis rezultateve të të nxënit - procedurave të mësimdhënies dhe të nxënit - vlerësimit, përbëjnë atë që në metodologjinë e sotme quhet "trekëndëshi magjik". Ky trekëndësh paraqet marrëdhënien koherente midis rezultateve të të nxënit, veprimtaritë e mësimdhënies/të nxënit dhe vlerësimin. Këta tre komponentë janë në koherencë me njëri-tjetrin, me qëllim që nxënësit të inkurajohen për të mësuar, të jenë pjesëmarrës aktivë në ndërtimin e

dijes dhe të shkathtësive.




Burimi: *Metodologji e mësimdhënies,* (faqe 102), B. Musai, 2014.  Botuar në Tiranë: CDE

> ***Zgjeroni dhe thelloni dijet***
> *Për më shumë lexoni në: Musai. B. (2014) Metodologji e mësimdhënies.Tiranë: CDE, faqe 101-128.*

Metodologjia e çdo teme zhvillohet në mënyrë pamore rreth mësimit të librit të nxënësit, e cila ju ndihmon ta shikoni atë pa pasur nevojën që ta keni pranë. Përdorimi i kësaj mënyre të paraqitjes metodologjike të mësimit ka dhënë rezultate mjaft të mira.

Metodologjia ndërvepruese ka si qëllim përfshirjen aktive të nxënësve në ndërtimin e dijes dhe formimin e shprehive. Zhvillimi i nxënësve që mendojnë në mënyrë kritike e që janë krijues është në qendër të metodave të mësimdhënies, të mënyrave të të nxënit e të çdo veprimtarie tjetër, me synim zhvillimin e shprehive të të menduarit të nivelit të lartë. Por, nga ana tjetër, jemi mbështetur edhe në parimet e psikologjisë së edukimit, kryesisht të zhvillimit njohës sipas moshave, me konsideratë të veçantë Zonën e Zhvillimit Proksimal të Vigotskit, e cila është zona midis nivelit aktual të zhvillimit të fëmijës sipas përcaktimit të aftësive për zgjidhjen e pavarur të problemeve dhe nivelit të zhvillimit që fëmija është në gjendje të arrijë, përmes orientimit të të rriturve, apo në bashkëpunim me bashkëmoshatarët e tij më të aftë. Kjo është një hapësirë dinamike ku mësimdhënia mund të japë rezultate e ndodhet diku midis asaj që nxënësi di dhe asaj që nxënësi nuk është gati të mësojë. Zona e zhvillimit proksimal është hapësira e mësimit midis së mërzitshmes dhe së pamundurës. Në këtë hapësirë, mbështetja nga mësuesi/ja apo nga një bashkëmoshatar mund të bëjë që mësimi të japë rezultate.

> ***Zgjeroni dhe thelloni dijet***
> *Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011) Psikologji edukimi.Tiranë: CDE, faqe 47-51.*




Burimi: *Psikologji edukimi,* (faqe 47), A. Woolfolk, 2011. Botuar në Tiranë: CDE

Sipas Piazhesë, fëmijët e klasës së parë dhe të dytë bëjnë pjesë në stadin paraoperacional dhe proceset kryesore të të menduarit tek ata bazohen kryesisht në vëzhgim. Në këtë mënyrë, është e mundur të kultivohen elementet dhe shprehitë e para të të menduarit kritik; por edukimi në mënyrë sistematike i tyre, që bëhet më pas shprehi e rëndësishme e të menduarit të nivelit të lartë, fillon në klasën e tretë. Për këtë arsye, mësimet janë të strukturuara në disa hapa të thjeshtë, të cilët me kujdes dhe në mënyrë të përshkallëzuar japin ndihmesën e tyre në ndërtimin dhe krijimin e dijeve, si dhe në formimin e shprehive.

***Zgjeroni dhe thelloni dijet***
*Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011) Psikologji edukimi.Tiranë: CDE, faqe 32-36.*

## Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 1

| I | Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv |
|---|---|
| 1. | Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës. |
| 2. | Shkruan një tekst të shkurtër (rreth një gjysmë faqeje - rreth 250 fjalë) për një temë të caktuar. |
| 3. | Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash. |
| 4. | Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësuesi), përmbajtja e të cilit nuk është më shumë se një faqe tekst i shtypur. |
| 5. | Shpreh mesazhin e dhënë të një teksti të thjeshtë letrar të lexuar, përmes njërës nga format shprehëse, si: të folurit, shkrimi, vizatimi, dramatizimi (luajtja në role), këndimi apo vallëzimi. |
| 6. | Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo loje, që është i përshtatshëm për moshën dhe performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët. |
| 7. | Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore, si dhe e prezanton para të tjerëve. |
| 8. | Shpreh për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi, drame ose dokumentari (të përshtatshëm për moshën e vet), dëgjimit të një tregimi, shikimit apo performimit të një vallëzimi, dëgjimit apo interpretimit të një kënge apo melodie, në njërën nga format shprehëse. |
| 9. | Emërton në gjuhën e huaj objekte, veprime ose dukuri dhe i përkthen në gjuhën amtare fjalët që i dëgjon nga gjuha e huaj, të dhëna në detyrë. |

| II. | Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ |
|---|---|
| 1. | Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta. |
| 2. | Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një probleme matematike (me veprimet themelore matematikore) me të cilën është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore. |
| 3. | Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga matematikore) e ndryshme ricikluese, duke u mbështetur në imagjinatën e vet. |
| 4. | Krahason objektet, lëndët e ndryshme, të paraqitura nga mësuesi, duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë a në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre. |
| 5. | Veçon shenjat e rrezikut të komunikacionit apo të rreziqeve të tjera nga shenjat e tjera informuese të dhëna si detyrë dhe tregon domethënien e njërës prej tyre në njërën nga format shprehëse, duke elaboruar me shembuj që tregojnë se si duhet të sillet në rast rreziku. |
| 6. | Gjen dhe ndan në grup veçoritë e përbashkëta dhe veçoritë dalluese ndërmjet gjallesave, ndërmjet ngjarjeve apo ndërmjet dukurive të njohura për të, shkruan për këto, të paktën, një gjysmë faqeje të fletores (rreth 250 fjalë) apo i paraqet në njërën nga format shprehëse. |
| 7. | Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna. |
| 8. | Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minutash. |

| III. | Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm |
|---|---|
| 1. | Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton përzgjedhjen që ka bërë. |
| 2. | Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. |
| 3. | Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit. |
| 4. | Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes. |
| 5. | Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë/aktivitet, duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shenjim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa kërkon zgjidhjen e problemit të dhënë. |
| 6. | Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale. |
| 7. | Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla/informacione kur has në vështirësi. |

| IV. | Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv |
|---|---|
| 1. | Përgatit një plan të thjeshtë ditor, me shkrim, me vizatim, me shenja apo me simbole, me dy-tri aktivitete ditore të vetat duke pasur parasysh kohën, vendin, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e tyre. |
| 2. | Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). |
| 3. | Diskuton me moshatarët për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë apo për një grup të caktuar njerëzish në raport me të tjerët apo me mjedisin që e rrethon gjatë realizimit të një aktiviteti të caktuar. |
| 4. | Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet ndonjë aktiviteti që bëhet në shkollë me atë në shtëpi, i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit dhe më pas i diskuton në grup. |
| 5. | Identifikon burimet e nevojshme (materialet, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet. |
| 6. | Diskuton në grup për hapësirat e pastra, të sigurta dhe anasjellas në mjedisin që e rrethon dhe tregon të paktën një mënyrë të veprimit për mbikëqyrje apo për përmirësim të gjendjes. |

| V. | Kompetenca personale – Individ i shëndoshë |
|---|---|
| 1. | Prezanton para të tjerëve rregullat themelore të higjienës personale (p.sh., fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit në të cilin jeton dhe vepron. |
| 2. | Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime, grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer si dhe menaxhon emocionet e veta si në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet). |
| 3. | Bën një listë (me njërën nga format shprehëse, si shkrim, vizatim etj.) me ushqimet të cilat i konsumon dhe i rendit ato sipas rëndësisë që kanë për shëndetin dhe mirëqenien e vet dhe ndërmerr masa preventive për t'u mbrojtur nga sëmundjet që shkaktohen nga përdorimi i tepruar dhe nga papastërtia e tyre. |
| 4. | Tregon mënyrën e shfrytëzimit dhe të menaxhimit të kohës së lirë në të mirë të shëndetit dhe mirëqenies së vet, ndan përvojat me të tjerët. |
| 5. | Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj. |
| 6. | Tregon mënyrat e zgjidhjes së një konflikti në të cilin është përfshirë apo të ndonjë konflikti në rrethin e tij, ndan mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit. |
| 7. | Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.). |

| VI | Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm |
|---|---|
| 1. | Prezanton rolet dhe detyrat e anëtarëve të familjes së vet apo të ndonjë grupi në të cilin është pjesëmarrës (grup loje, aktiviteti), me theks në detyrat e veta dhe i diskuton me bashkëmoshatarë. |
| 2. | Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj. |
| 3. | Arsyeton nevojën e zbatimit të rregullave në lojë, në klasë/shkollë, në rrugë apo në familje dhe paraqet pasojat e moszbatimit të ndonjë rregulle në shembullin e caktuar. |
| 4. | Identifikon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si, p.sh., besimin e ndërsjellë, tolerancën, solidaritetin, respektin, mirësjelljen etj.). |
| 5. | Veçon ndonjë organizim në familje, në klasë apo në lagje dhe i përshkruan, përmes formave të ndryshme të shprehjes, kontributin individual të anëtarëve për realizimin e përbashkët të tij. |
| 6. | Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar. |
| 7. | Identifikon personat dhe shërbimet e nevojshme nga të cilat kërkohet ndihma në situata të rrezikut për shëndetin e vet, fizik apo mendor, të shkaktuar nga natyra apo nga njeriu (një ngjarje e dhënë nga mësuesi/ja apo e marrë nga jeta e përditshme), më pas për këtë diskuton në grup. |

## REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS EDUKATË FIZIKE, SPORTET DHE SHËNDETI
## Shkalla 1

| I. | **NJOHURITË, TË KUPTUARIT DHE SHKATHTËSITË** që zhvillohen |
|---|---|
| | **1. Njohja dhe kuptimi i rëndësisë së mirëqenies fizike, psikike, emocionale dhe sociale** |
| | **Nxënësi/ja:** |
| **1.** | Tregon për ndjenjat e tij/saj në situatat e jetës se përditshme dhe identifikon të drejtat dhe përgjegjësitë e tij/saj. |
| **2.** | Identifikon rreziqet e ndryshme në shtëpi, në shkollë dhe në mjedisin ku jeton. |

| 2. | **Përdorimi i aftësive dhe shkathtësi lëvizore në aktivitete fizike dhe sportive** |
|---|---|
| | **Nxënësi/ja:** |
| **1.** | Demonstron kombinime me lëvizje të ndryshme jolokomotore (tërheqje, shtytje, ekuilibrim, kthim, rrotullim etj.), lokomotore (ecje, vrapim, kërcim etj.) dhe merret me sporte të tjera. |
| **2.** | Merr pjesë aktive duke zhvilluar shkathtësitë lëvizore nëpërmjet lojërave elementare dhe popullore. |

| 3. | **Krijimi i shprehive për një stili jete aktive dhe të shëndetshme** |
|---|---|
| | **Nxënësi/ja:** |
| **1.** | Dallon mënyrën e drejtë të të ushqyerit sipas rutinës, ushqimin e shëndetshëm dhe jo të shëndetshëm dhe shpjegon ndikimin e të ushqyerit në rritje dhe në zhvillim. |
| **2.** | Demonstron shkathtësi dhe shprehi për mirëmbajtjen e higjienës personale në shtëpi, në shkollë dhe në mjedis. |

| 4. | **Kuptimi i ndikimit të përdorimit të substancave që krijojnë varësi në jetën e individit dhe të shoqërisë** |
|---|---|
| | **Nxënësi/ja:** |
| **1.** | Identifikon produktet dhe mjetet, të cilat nuk preken dhe nuk konsumohen, dhe kupton se çfarë janë barnat dhe substancat e dëmshme. |

| 5. | **Shfrytëzimi i mjedisit natyror për zhvillimin e aktiviteteve fizike dhe interesimi për t'u kujdesur për mjedisin** |
|---|---|
| | **Nxënësi/ja:** |
| **1.** | Kupton rëndësinë e zhvillimit të vazhdueshëm të aftësive fizike dhe ndikimin e mjedisit në shëndetin dhe cilësinë e jetës. |

| II. | **QËNDRIMET DHE VLERAT** që zhvillohen |
|---|---|
| | **Nxënësi/ja:** |

- Respekton veten dhe të tjerët;
- I/e përgjegjshëm/e;
- Tolerant/e;
- Respektimi i diversitetit;
- I/e përkushtuar;
- Ka qëndrim pozitiv;
- Bashkëpunues/e;
- Respekton kodin e mirësjelljes;
- Respekton kodin e veshjes;
- Respekton rregulloret;
- Gatishmëri;
- I/e sigurt.

## III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen

**Nxënësi/ja:**

- Njeh veten dhe të tjerët;
- Kupton veten dhe të tjerët;
- Tregon për veten, për familjen dhe për mjedisin;
- Identifikon rreziqet e ndryshme;
- Kupton ndikimin e veprimeve pozitive dhe negative;
- Shpjegon ndikimin e aktiviteteve sportive;
- Emërton pjesët e trupit;
- Shpjegon emocionet;
- Shkëmben përvojat;
- Diskuton;
- Pjesëmarrje aktive;
- Ushtron të drejtat e veta;
- Shpjegon;
- Menaxhon emocionet;
- Demonstron sjelle, veprime, shprehi;
- Zbaton parimet;
- Përshkruan llojet e ushqimit, aktivitetet fizike;
- Qëndrim të drejtë trupor;
- Praktikon ushtrime;
- Ndërton bashkëpunim;
- Harton rregullore;
- Hulumton.

## Planifikimi vjetor i temave mësimore për fushën e kurrikulës: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Klasa II

| Lëndët e fushës kurrikulare | TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE | | | | Rezultatet e Kompetencave (Rezultatet e të nxënit për shkallë) |
|---|---|---|---|---|---|
| | PERIUDHA I | | PERIUDHA II | PERIUDHA III | |
| | shtator—tetor | nëntor—dhjetor | janar—shkurt—mars | prill—maj—qershor | |
| Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti | Përkujdesja ndaj vetes dhe të tjerëve<br><br>I shëndoshë dhe i lumtur | Aktivitetet psikomotorike dhe koordinimi i tyre<br><br>Lojërat lëvizore dhe rëndësia e pushimit aktiv | Lojërat lëvizore dhe rëndësia e pushimit aktiv<br><br>Ushqimi i shëndetshëm dhe shprehitë e të ushqyerit | Mbrojtja dhe siguria nga rreziqet e ndryshme<br><br>Kujdesi për mjedisin | Komunikues efektiv: I-1,2,3,5,6,7,8<br><br>Mendimtar kreativ; II-1,2,3,4,5,6,7<br><br>Nxënës i suksesshëm III-1,2,3,4,5,6,7<br><br>Kontribues produktiv IV-1, 2,3,4,5,6,7<br><br>Individ i shëdoshë V-1,2,3,4,5,6,7<br><br>Qytetar i përgjegjshëm VI-1,2,3,4,5,6,7 |
| | | | | | |

# PLANI DYMUJOR: SHTATOR—TETOR

## Lënda mësimore: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

**Fusha e kurrikulës:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti **Klasa:** II

**Temat mësimore:** Përkujdesja ndaj vetes dhe të tjerëve
I shëndoshë dhe i lumtur

| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: |
| --- |
| I.3,6; II.8; III.2,3,7; IV.2,3; V.2,4,5,6; VI.2,3,4,6; |

| Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: |
| --- |
| 1.1,2 |

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore | Njësitë mësimore | Koha mësimore (orë mësimore) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Përkujdesja ndaj vetes dhe të tjerëve**<br><br>**I shëndoshë dhe i lumtur** | - Tregon kujdes për veten dhe të tjerët në mënyra të ndryshme krijuese.<br>- Menaxhon emocionet gjatë lojës, punës grupore, bashkëveprimit me të tjerët.<br>- Gjykon veprimet e veta dhe të tjerëve në situata të caktuara.<br>- Paraqet në forma të ndryshme individin e shëndoshë dhe të jetuarit e shëndetshëm.<br>- Tregon rolin që kanë individët/institucionet që ofrojnë ndihmë në situata të caktuara.<br>- Tregon për simptoma të gjendjes jo të mirë shëndetësore dhe di të kërkojë ndihmë. | 1. Matjet antropometrike (Zh)<br>2. “Shamia e humbur” (Zh)<br>3. “Pasqyra” (Zh)<br>4. Dhëmbët (Zh)<br>5. Simptomat e gripit (Zh)<br>6. Vrapojmë për shëndetin (Zh)<br>7. Vrapimet nga pozita të ndryshme (Zh)<br>8. Drejtqëndrimi – balancimi (Zh)<br>9. Ushtrimet formimi - imitimi i kafshëve (Zh)<br>10. Ecja e drejtë në traun e ulët dhe në vijat të caktuara (Zh)<br>11. Ecja me duar dhe këmbë, sipas kombinimit (Zh)<br>12. Dëgjo rregullat! (Zh)<br>13. “Shishet e rrëzuara” (Zh)<br>14. “Grupi më i shpejtë” (Zh)<br>15. “Lexo dhe vepro” (Zh)<br>16. Pasimi i topit nga pozita të ndryshme (Zh)<br>17. Hedhja (shtytja) e topit me një dorë (Zh)<br>18. Pasimi i topit me këmbë - Gjuajtja e topit me këmbë | 18 | - Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj). | - Vlerësimi diagnostikues<br>- Listat e kontrollit | Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm | “Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti 2”,<br><br>Sh.B. “Dukagjini”<br>Burime nga interneti |

# PLANI DYMUJOR: NËNTOR—DHJETOR

**Lënda mësimore: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti**

**Fusha e kurrikulës:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti **Klasa:** II

**Temat mësimore:** Aktivitetet psikomotorike dhe koordinimi i tyre
Lojërat lëvizore dhe rëndësia e pushimit aktiv

| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:** |
|---|
| I.3,6; II.8; III.2,3,5.7; IV.2,4,5; V.2,5,7; VI.1,2,3,6; |

| **Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:** |
|---|
| 2.1; 2.2; |

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore | Njësitë mësimore | Koha mësimore (orë mësimore) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Aktivitetet psikomotorike dhe koordinimi i tyre**<br><br>**Lojërat lëvizore dhe rëndësia e pushimit aktiv** | - Aplikon teknikën e duhur të frymëmarrjes dhe nxehjes para, gjatë dhe pas aktiviteteve dhe ushtrimeve fizike.<br>- Zbaton pozicionet e sakta të drejtqëndrimit në pozitat ulur, në këmbë, në vend dhe në lëvizje.<br>- Respekton rregullat dhe<br>- udhëzimet e sigurta gjatë lojërave, aktiviteteve apo përdorimit të mjeteve, rekuizitave dhe pajisjeve të ndryshme.<br>- Aplikon ushtrime me elemente të hapësirës, gjerësisë, formës, forcës, shpejtësisë, kohës dhe ritmit të lëvizjes.<br>- Demonstron koordinim lëvizor në lëvizje të thjeshta manipulative në raport me mjetet në dispoziocion.<br>- Aplikon teknikat fillestare të kapërdimit para kërcimit me pengesa të ndryshme dhe goditjes në shenjë. | 19. "Të lëvizim me ritëm" (Zh)<br>20. "Gjej hapësirën tënde" (Zh)<br>21. "Kapja e shkopit"<br>22. "Bartja e rrethit duke u rrokullisur"(Zh)<br>23. Rrotullimi anash i shtrirë (Zh)<br>24. Kapërdimi para (Zh)<br>25. Vrapimi me pengesa (Zh)<br>26. "Bredhi i Vitit të Ri" (Zh)<br>27. Si të çlodhemi? (Zh)<br>28. Si të vishem gjatë aktivitetit fizik dhe pas tij? (Zh)<br>29. Higjiena personale pas aktivitetit fizik (Zh)<br>30. "Poligoni" (Zh)<br>31. Koordimi i lëvizjeve (Zh)<br>32. Vrapim 2 x 20 m (Zh)<br>33. Tërheqja e shokut (Zh)<br>34. "Ecja në kolonë" (Zh) | 16 | - Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj). | - Vlerësimi diagnostikues<br>- Listat e kontrollit | Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm | "Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti 2", Sh.B. "Dukagjini"<br><br>Burime nga interneti |

# PLANI TREMUJOR: JANAR—SHKURT—MARS

**Lënda mësimore: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti**

**Fusha e kurrikulës:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti **Klasa:** II

**Temat mësimore:** Lojëra lëvizore dhe rëndësia e pushimit aktiv
Ushqimi i shëndetshëm dhe shprehitë e të ushqyerit

| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:** |
| --- |
| I.3,4,5; II.4,6,8; III.3,6,7; IV.2,4,5,6; V.2,3,5,7; VI.2,3,6; |

| **Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:** |
| --- |
| 1.1,2; |

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore | Njësitë mësimore | Koha mësimore (orë mësimore) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Lojërat dhe rëndësia e pushimit aktiv**<br><br>**Ushqimi i shëndetshëm dhe shprehitë e të ushqyerit** | - Dallon shenjat e lodhjes dhe praktikon mënyrat e çlodhjes gjatë lojës dhe ushtrimeve.<br>- Vishet në mënyrën e duhur dhe ruan higjienën personale, gjatë dhe pas aktiviteteve fizike brenda dhe jashtë shkollës.<br>- Diskuton për shpehitë e shëndetshme të të ushqyerit. | 35. "Orientimi" (Zh)<br>36. Gjuajtja e topit në shportë (Zh)<br>37. Kërcimi me litar (Zh)<br>38. "Zgjidh ngjyrat" (Zh)<br>39. Kërcimi i pengesave (Zh)<br>40. Grumbullimi i koneve (Zh)<br>41. Vrapim me matje të kohës (Zh)<br>42. Rreshtimi (Zh)<br>43. Ushtrime të forcës (Zh)<br>44. Pasimi i topit me gishta - Pasimi i topit për tokë (Zh)<br>45. Pasimi i topit me një dorë<br>46. Udhëheqja e topit me këmbë (Zh)<br>47. "Kalimi i topit në tunel" (Zh)<br>48. "Lëvizja me litar" (Zh)<br>49. "Ndërro ngjyrën" (Zh)<br>50. "Rrëzo topat" (Zh)<br>51. "X-O" (Zh)<br>52. "Shamia" (Zh)<br>53. "Zogjtë dhe dhelprat" (Zh)<br>54. "Bletët, grerëzat dhe mjalti" (Zh) | 20 | - Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj). | - Vlerësimi diagnostikues<br>- Lista e kontrollit | Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm | "Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti 2", Sh.B. "Dukagjini"<br><br>Burime nga interneti |

# PLANI TREMUJOR: PRILL—MAJ—QERSHOR

**Lënda mësimore: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti**

**Fusha e kurrikulës:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti **Klasa:** I

**Temat mësimore:** Mbrojtja dhe siguria nga rreziqet e ndryshme
Kujdesi për mjedisin

| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: |
|---|
| I.3,6; II.2,3; III.2,3; IV.2,4; V.2,4,5,6,7; VI.2,3,4,6; |

| Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: |
|---|
| 1.1,2 |

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore | Njësitë mësimore | Koha mësimore (orë mësimore) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Mbrojtja dhe siguria nga rreziqet e dryshme**<br><br>**Kujdesi për mjedisin** | - Dallon mjediset e përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve fizike. Vlerëson rëndësinë e mjedisit të pastër gjatë aktiviteteve sportive.<br>- Zbaton praktikat higjenike para, gjatë dhe pas ushqimit.<br>- Shpjegon prejardhjen e ushqimeve që konsumon.<br>- Dallon vlerat ushqyese të produkteve që konsumon.<br>- Vlerëson ndikimin e ushqimit dhe aktiviteteve fizike në shëndet.<br>- Kupton rëndësinë e përdorimit të barnave për shëndetin e tij/saj.<br>- Përshkruan shenjat e rrezikut nga përdorimi i substancave dhe preparateve të ndryshme.<br>- Identifikon personat apo institucionet ku mund të kërkojë ndihmë.<br>- Identifikon faktorët e mjedisit të jashtëm që ndikojnë në zhvillimin e tij/saj. | 55. "Kalojmë nëpër rrathë" (Zh)<br>56. "Helikopteri i caktuar" (Zh)<br>57. "Formojmë numër" (Zh)<br>58. "Kush është më i sakti?" (Zh)<br>59. "Mbaje në mend" (Zh)<br>60. "Fusha e minuar" (Zh)<br>61. "Fishekzjarri" (Zh)<br>62. "Stafeta e pasuar" (Zh)<br>63. "Qëllo në shenjë" (Zh)<br>64. Higjiena para dhe pas ushqimit (Zh)<br>65. Cili është ushqimi i shëndetshëm? (Zh)<br>66. Si i pastrojmë frutat dhe perimet? (Zh)<br>67. Vlerat e frutave (Zh)<br>68. Rëndësia e barnave (Zh)<br>69. Rreziku nga barnat (Zh)<br>70. Mjedisi i jashtëm (Zh)<br>71. Ta mbajme mjedisin e pastër! (Zh).<br>72. Faktorët që ndikojnë në zhvillimin tim (Zh)<br>73. Mjedisi im i përshtatshëm (Zh)<br>74. Tetëkahore (P) | 20 | - Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj). | - Vlerësimi diagnostikues<br>- Lista e kontrollit | Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm | "Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti 2", Sh.B. "Dukagjini"<br><br>Burime nga interneti |

## Mësimi 1

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II
**Tema:** Përkujdesje ndaj vetes dhe të tjerëve

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Paraqet në forma të ndryshme njeriun e shëndoshë dhe të jetuarit shëndetshëm.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.8; III.7; IV.3,4; V.2,5; VI.1.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 3.


Matjet antropometrike

| Matjet e trupit tim | të tanishmet | të vitit të kaluar | ndryshimet |
|---|---|---|---|
| Gjatësia | | | |
| Pesha | | | |
| Perimetri i kokës | | | |
| Perimetri i kraharorit | | | |
| Gjatësia e dorës | | | |
| Gjatësia e shuplakës | | | |
| Gjatësia e këmbës | | | |
| Gjatësia e shputës | | | |

Ndryshimet që unë i kam pësuar për 1 vit:

Unë jam zgjatur ________, ndërsa kam shtuar________.Perimetri i kokës është rritur __________, perimetri i kraharorit është rritur ______.

7

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Matjet antropometrike

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan karakteristikat fizike;
- Shënon të dhënat sipas kërkesave;
- Krahason ndryshimet e arritura për një vit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Hapi 1:** Udhëzohen nxënësit të shohin veten në pasqyrë dhe pyeten:

- Cilat pjesë të trupit i vërejtët në pasqyrë?

Dëgjohen mendimet e nxënsëve.

Përgjigje e mundshme: Unë po shoh kokën, duart, këmbët etj.



Matjet antropometrike

| Matjet e trupit tim | të tanishmet | të vitit të kaluar | ndryshimet |
|---|---|---|---|
| Gjatësia | | | |
| Pesha | | | |
| Perimetri i kokës | | | |
| Perimetri i kraharorit | | | |
| Gjatësia e dorës | | | |
| Gjatësia e shuplakës | | | |
| Gjatësia e këmbës | | | |
| Gjatësia e shputës | | | |

Ndryshimet që unë i kam pësuar për 1 vit:

Unë jam zgjatur ________, ndërsa kam shtuar________.Perimetri i kokës

është rritur ___________, perimetri i kraharorit është rritur ______.

7

**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen t'i kryejnë matjet trupore një nga një.
Të dhënat e matjeve trupore do t'i shënojnë në libër te kolona "e tanishme".
Te kolona "e vitit të kaluar" i shënojnë të dhënat trupore të marra nga libri i klasës së parë. Ndërsa te kolona e fundit "ndryshimet", ata i shënojnë ndryshimet e matjeve trupore që i kanë arritur.



**Hapi 3:** Diskutohet me nxënës për ndryshimet që kanë pasur për një vit.

- Sa kilogramë i keni shtuar?
- Sa jeni zgjatur?

Ndryshimet e tyre ata do t'i shënojnë në libër sipas udhëzimeve.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për mënyrën e përshkrimit të karakteristikave fizike dhe për krahasimin e ndryshimit gjatë një viti.

**Detyrë:**

______________________________

______________________________

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:* ______________________________

______________________________

# Mësimi 2

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE


"Shamia e humbur"

Të vendosur në formë rrethore, nxënësit rrinë ulur. Një nxënës, me shami në dorë, vrapon rreth nxënësve dhe e lëshon shaminë prapa dikujt pa u dalluar.

Nxënësi që e ka shaminë prapa, e merr dhe e ndjek shokun që ia la shaminë, derisa ta kapë ose të ulet në vendin e tij.

"Pasqyra"

Nxënësit janë të vendosur në çifte përballë njëri-tjetrit.

Njëri është "pasqyra", ndërsa tjetri "njeriu". "Pasqyra" duhet ta imitojë "njeriun", por si një "pasqyrë" e vërtetë.

Fiton kush nuk bën gabime.

8

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II
**Tema:** Përkujdesje ndaj vetes dhe të tjerëve

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Respekton rregullat dhe udhëzimet e sigurta gjatë lojërave, gjatë aktiviteteve apo gjatë përdorimit të mjeteve, të rekuizitave dhe të pajisjeve të ndryshme.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; V.2,5,7.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,3.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** "Shamia e humbur"

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan përdorimin e shamisë;
- Demonstron sipas rregullave.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Shami.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Hapi 1:** Para nxënësve paraqitet një shami e kuqe dhe pyeten:

- Për çfarë na shërben kjo shami?

Përgjigje e mundshme: Me këtë shami hedhim valle.



"Shamia e humbur"

Të vendosur në formë rrethore, nxënësit rrinë ulur. Një nxënës, me shami në dorë, vrapon rreth nxënësve dhe e lëshon shaminë prapa dikujt pa u dalluar.

Nxënësi që e ka shaminë prapa, e merr dhe e ndjek shokun që ia la shaminë, derisa ta kapë ose të ulet në vendin e tij.

"Pasqyra"

Nxënësit janë të vendosur në çifte përballë njëri-tjetrit.

Njëri është "pasqyra", ndërsa tjetri "njeriu". "Pasqyra" duhet ta imitojë "njeriun", por si një "pasqyrë" e vërtetë.

Fiton kush nuk bën gabime.

8

**Hapi 2:** Udhëzohen nxënësit që të ulen në dysheme në formë rrethore.

Atyre më pas u shpjegohet se do të zhvillojnë lojën "Shamia e humbur". Ai që e fillon lojën, ka shaminë në dorë dhe vrapon rreth nxënësve për t'ia lënë dikujt tjetër.

Rregull e lojës është moshyrja në mes të rrethit, por gjithmonë duhet të vrapojnë rreth nxënësve për t'i ikur vrapuesit.

**Hapi 3:** Loja përsëritet derisa secili nxënës ta ketë në dorë shaminë.
Ai i cili fiton më shumë herë, shpallet fitues.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për shkathtësitë në lojë sipas rregullave.

**Detyrë:**

___

___

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

___

## Mësimi 3

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II
**Tema:** Përkujdesja ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Përkujdesja ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** V.2,5,7.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,3.



*"Shamia e humbur"*

Të vendosur në formë rrethore, nxënësit rrinë ulur. Një nxënës, me shami në dorë, vrapon rreth nxënësve dhe e lëshon shaminë prapa dikujt pa u dalluar.

Nxënësi që e ka shaminë prapa, e merr dhe e ndjek shokun që ia la shaminë, derisa ta kapë ose të ulet në vendin e tij.

*"Pasqyra"*

Nxënësit janë të vendosur në çifte përballë njëri-tjetrit.

Njëri është "pasqyra", ndërsa tjetri "njeriu". "Pasqyra" duhet ta imitojë "njeriun", por si një "pasqyrë" e vërtetë.

Fiton kush nuk bën gabime.

8

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** "Pasqyra"

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan veprimet që i bën para pasqyrës;
- Demonstron me emocion lëvizjet.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Pasqyrë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Para nxënësve vendoset një pasqyrë dhe pyeten:

- *Çfarë bëni para pasqyrës?*

Përgjigje e mundshme: para pasqyrës vishem, i laj dhëmbët, i laj sytë etj.

**Hapi 2:** Udhëzohen nxënësit që të vendosen në dy rreshta përballë njëri-tjetrit.

Njëri rresht i nxënësve do të jetë pasqyra, kurse rreshti tjetër do të jenë aktorët.

Paraqiten emocionet pozitive, siç janë: forca, guximi, lumturia, trimëria ose paqja.
Rreshti ku janë aktorët këtë emocion e demonstrojnë, kurse rreshti i pasqyrës duhet t'i imitojnë aktorët.



"Shamia e humbur"

Të vendosur në formë rrethore, nxënësit rrinë ulur. Një nxënës, me shami në dorë, vrapon rreth nxënësve dhe e lëshon shaminë prapa dikujt pa u dalluar.

Nxënësi që e ka shaminë prapa, e merr dhe e ndjek shokun që ia la shaminë, derisa ta kapë ose të ulet në vendin e tij.

"Pasqyra"

Nxënësit janë të vendosur në çifte përballë njëri-tjetrit.

Njëri është "pasqyra", ndërsa tjetri "njeriu". "Pasqyra" duhet ta imitojë "njeriun", por si një "pasqyrë" e vërtetë.

Fiton kush nuk bën gabime.

8

**Hapi 3:** Rreshtat i ndërrojnë rolet për çdo emocion, një herë aktori, një herë pasqyra.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit do të vlerësohen për demonstrimin me emocion të lëvizjeve.

**Detyrë:**

___________________________________________

___________________________________________

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

___________________________________________

___________________________________________

# Mësimi 4

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II
**Tema:** Përkujdesja ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Tregon kujdes për veten dhe për të tjerët në mënyra të ndryshme krijuese.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** V.1.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,3.



Dhëmbët

Fëmijët deri në moshën 6-vjeçare i kanë vetëm dhëmbët e qumështit. Nga mosha 6-vjeçare, fillon dhe dalja e dhëmbëve të përhershëm.
Fusha e stomatologjisë që merret me fëmijët quhet pedodonti.
Dhëmbët e qumështit bien me kalimin e kohës, duke ua lënë vendin dhëmbëve të përhershëm. Dhëmbët e qumështit frontalë (pra, dhëmbët e parë) duhet të ruhen deri në moshën 7-8-vjeçare, kurse ata posteriorë (pra, dhëmbët e pasmë) deri në atë 12-13-vjeçare.

9

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Dhëmbët

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan personazhin;
- Diskuton për dhëmbët;
- Demonstron larjen e dhëmbëve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** furçë, pastë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Hapi 1:** Udhëzohen nxënësit të përshkruajnë personazhin e librit.

Ata pyeten:

- *Çfarë veprimi po kryen?*

Përgjigje e mundshme: Ajo po i lan dhëmbët.



Dhëmbët

Fëmijët deri në moshën 6-vjeçare i kanë vetëm dhëmbët e qumështit. Nga mosha 6-vjeçare, fillon dhe dalja e dhëmbëve të përhershëm.
Fusha e stomatologjisë që merret me fëmijët quhet pedodonti.
Dhëmbët e qumështit bien me kalimin e kohës, duke ua lënë vendin dhëmbëve të përhershëm. Dhëmbët e qumështit frontalë (pra, dhëmbët e parë) duhet të ruhen deri në moshën 7-8-vjeçare, kurse ata posteriorë (pra, dhëmbët e pasmë) deri në atë 12-13-vjeçare.

9

**Hapi 2:** Diskutohet për tekstin e lexuar me nxënësit. Fusha e stomatologjisë, e cila merret me fëmijët, quhet pedodonti.
Ata pyeten:

- *Deri në cilën moshë fëmijët i kanë dhëmbët e qumështit?*

Përgjigjet e mundshme: Deri në moshën 6-vjeçare.

- *Nga cila moshë fillon dalja e përhershme e dhëmbëve?*

Përgjigje e mundshme: Nga mosha 6-vjeçare.

**Hapi 3:** Kërkohet nga nxënësit të demonstrojnë lëvizjet e furçës nëpër dhëmbë gjatë larjes.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit do të vlerësohen për mënyrën e dhënies së përgjigjeve gjatë diskutimit dhe demonstrimin gjatë pastrimit.

**Detyrë:**

______________________________

______________________________

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:* ______________________________

______________________________

# Mësimi 5

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II
**Tema:** Përkujdesja ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Tregon kujdes për veten dhe për të tjerët në mënyra të ndryshme krijuese.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** III.4; V.1.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,3.



Simptomat e gripit

Gripi është sëmundje që mund të përhapet nga personi në person, nëpërmjet kollës, teshtimës si dhe kontakteve të ndryshme. Simptomat e gripit mund të jenë: temperatura, ethet, lodhja, dhembja e fytit, kolla, dhembja e muskujve, dhembja e kokës, dhembja e barkut, të vjellat, rrjedhja e hundëve etj.

Disa veprime që ndihmojnë në parandalimin e gripit:
- Shmangni kontaktet me persona të sëmurë.
- Nëse jeni të sëmurë, qëndroni në shtëpi për të paktën një ditë.
- Kur teshtini ose kolliteni, vini shaminë ose dorën te goja dhe hunda.
- Pastroni duart sa më shpesh me sapun.
- Mos e prekni fytyrën me duar të papastra.

10

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Simptomat e gripit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan veprimin e personazhit;
- Identifikon simptomat e gripit;
- Diskuton për parandalimin e sëmundjeve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Udhëzohen nxënësit që të shikojnë personazhin dhe të fillojnë diskutimin.

Diskutim rreth pyetjes:

- *Pse është i shtrirë personazhi?*

Përgjigje e mundshme: Sepse ai është i sëmurë.

**Hapi 2:** Diskutohet për të identifikuar simptomat e gripit.

- *Si përhapet sëmundja e gripit?*



Simptomat e gripit

Gripi është sëmundje që mund të përhapet nga personi në person, nëpërmjet kollës, tështimës si dhe kontakteve të ndryshme. Simptomat e gripit mund të jenë: temperatura, ethet, lodhja, dhembja e fytit, kolla, dhembja e muskujve, dhembja e kokës, dhembja e barkut, të vjellat, rrjedhja e hundëve etj.

Disa veprime që ndihmojnë në parandalimin e gripit:
- Shmangni kontaktet me persona të sëmurë.
- Nëse jeni të sëmurë, qëndroni në shtëpi për të paktën një ditë.
- Kur teshtini ose kolliteni, vini shaminë ose dorën te goja dhe hunda.
- Pastroni duart sa më shpesh me sapun.
- Mos e prekni fytyrën me duar të papastra.

10

Përgjigje e mundshme: Mund të përhapet përmes kollës, teshtimës.

- *Cilat janë simptomat e gripit?*

Përgjigje e mundshme: Temperatura, ethet, lodhja.

**Hapi 3:** Diskutimi vazhdon me nxënësit rreth parandalimit të sëmundjeve me pyetjen:

- *Si mund të parandalojmë sëmundjet?*

Përgjigje e mundshme: Ta vizitojmë mjekun. Veprimet e përditshme, të cilat ndihmojnë në parandalimin e gripit:

- Shmangini kontaktet me njerëzit e sëmurë;
- Qëndroni në shtëpi të paktën një ditë, nëse jeni i sëmurë.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit do të vlerësohen për identifikimin e simptomave të gripit dhe përshkrimin e parandalimit.

**Detyrë:**

______________________________________________

______________________________________________

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:* ______________________________

______________________________________________

# Mësimi 6

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II
**Tema:** I shëndoshë dhe i lumtur

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Paraqet në forma të ndryshme njeriun e shëndoshë dhe të jetuarit shëndetshëm.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** V.2,5,7.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.


*Vrapojmë që të jemi të shëndetshëm*

Sot do të vrapojmë nëpër oborrin e shkollës, në ndonjë hapësirë të gjelbëruar ose në park afër shkollës.

Diskutoni:

- Sa ditë në javë vraponi?
- Ku dilni për të vrapuar?
- Me kë dilni?
- A është vrapimi i mirë për shëndetin tuaj?

11

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vrapojmë që të jemi të shëndetshëm

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Bisedohet rreth vrapimit;
- Luan lojën sipas udhëzimeve;
- Diskuton për rëndësinë e vrapimit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Top.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Hapet diskutimi me nxënësit dhe pyeten rreth vrapimit.

Diskutim rreth pyetjeve:

- *A vraponi çdo ditë?*
- *Më kë dhe ku vraponi?*

**Hapi 2:** Udhëzohen nxënësit që të rreshtohen në vijën e startit në oborrin e shkollës.

Pas rreshtimit, rrokulliset topi në oborr dhe të gjithë fëmijët duhet të vrapojnë pas topit që ta kapin atë.


Vrapojmë që të jemi të shëndetshëm

Sot do të vrapojmë nëpër oborrin e shkollës, në ndonjë hapësirë të gjelbëruar ose në park afër shkollës.

Diskutoni:

- Sa ditë në javë vraponi?
- Ku dilni për të vrapuar?
- Me kë dilni?
- A është vrapimi i mirë për shëndetin tuaj?

11

Ai që e kap topin, fiton një pikë.

Topi mund të rrokulliset në drejtime të ndryshme të hapësirës së lojës.
Rregullat e lojës janë se gjatë vrapimit ata nuk duhet të shtyhen ose ta rrëzojnë njëri-tjetrin.

**Hapi 3:** Diskutohet se vrapimet janë lëvizje fizike shumë të rëndësishme, që kanë efekte pozitive në zhvillimin e muskujve të trupit të tyre.
Shpallet fitues nxënësi që e ka kapur më shumë herë topin.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit do të vlerësohen për demonstrimin e lojës sipas udhëzimeve dhe pjesëmarrjen aktive në diskutim.

**Detyrë:**

___

___

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

___

# Mësimi 7

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II
**Tema:** I lumtur dhe i shëndoshë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Aplikon ushtrime me elemente të hapësirës, të gjerësisë, të formës, të forcës, të shpejtësisë, të kohës dhe të ritmit të lëvizjes.
**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** V.2,5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vrapime nga pozita të ndryshme

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan për mënyrën e vrapimit;
- Demonstron lojën duke respektuar rregullat;
- Diskuton përjetimet gjatë vrapimit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Top.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Hapet diskutimi me nxënësit rreth vrapimit.

Diskutim rreth pyetjeve:

- *Kur vraponi ju?*

Përgjigje e mundshme: Ne vrapojmë kur luajmë.



*Vrapime nga pozita të ndryshme*

Vrapimet janë të ndryshme. P.sh.: dikush vrapon më shpejt, dikush më ngadalë, mund të vrapohet në rrugë, në palestër, gjatë lojërave të ndryshme, por edhe nga pozita të ndryshme që do t'i provojmë së bashku.

Vrapim nga pozita në këmbë (normal).

Vrapim nga pozita ulur, kthyer me fytyrë nga mësuesi/ja.

Vrapim nga pozita ulur, të kthyer me shpinë.

Vrapimi nga pozita shtrirë.

Të gjitha vrapimet i bëjmë vetëm, në çifte dhe me më shumë nxënës.

14

**Hapi 2:** Nxënësit rreshtohen në hapësirën e lojës dhe përgatiten për fillimin e lojës.

Loja zhvillohet si në vazhdim.

Udhëzohen ata të bëhen si bleta dhe të vrapojnë me hapa të vegjël rreth e qark; mbajnë krahët anash dhe duart i rrahin pak poshtë, pak lart, gjatë kësaj kohe ata imitojnë bletët.

Nxënësit vrapojnë herë në të majtë, herë në të djathtë, duke i imituar bletët. Ata mund të ecin pupthi me ritëm të shpejtë ose të ngadaltë.

**Hapi 3:** Nxënësit disktojnë për përjetimet e tyre gjatë imitimit të bletëve.
Fitues shpallet ai që e ka imituar më mirë rolin e bletëve.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për demonstrimin e lojës sipas rregullave dhe për pjesëmarrje aktive në diskutim.

**Detyrë:**

___

___

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

___

## Mësimi 8

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE


Drejtqëndrimi - balancimi

Gjatë ecjes dhe qëndrimit në një vend, si dhe gjatë lojërave apo aktiviteteve të ndryshme, trupi duhet të qëndrojë drejt.

Ushtrime formimi - imitimi i kafshëve

Disa ushtrime formimi ngjajnë me lëvizjet e kafshëve të ndryshme, që i njohim ose i kemi në shtëpi. P.sh., zgjatjet ngjajnë shumë me lëvizjet e maceve.

Shkruaj disa shembuj:

15

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II
**Tema:** I lumtur dhe i shëndoshë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Zbaton pozicionet e sakta të drejtqëndrimit në pozitat ulur, në këmbë, në vend dhe në lëvizje.
**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** V.2,5,7.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Drejtqëndrimi - balancimi

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Diskuton për drejtqëndrimin;
- Praktikon lojën duke e mbajtur drejtqëndrimin.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë**.**

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Litar, tase.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Hapi 1:** Kërkohet nga nxënësit të vëzhgojnë pozitën e personazheve.

Diskutohet rreth pyetjes:

- *Pse personazhet i kanë krahët e hapur?*

Përgjigje e mundshme: Për ta mbajtur drejtqëndrimin.

**Hapi 2:** Në dyshemen e fushës vendoset litari.


Drejtqëndrimi - balancimi

Gjatë ecjes dhe qëndrimit në një vend, si dhe gjatë lojërave apo aktiviteteve të ndryshme, trupi duhet të qëndrojë drejt.

Ushtrime formimi - imitimi i kafshëve

Disa ushtrime formimi ngjajnë me lëvizjet e kafshëve të ndryshme, që i njohim ose i kemi në shtëpi. P.sh., zgjatjet ngjajnë shumë me lëvizjet e maceve.

Shkruaj disa shembuj:

15

Udhëzohen nxënësit që të ecin mbi litar dhe të provojnë ta mbajnë drejtqëndrimin - balancimin deri në fund të litarit.

Ata duhet të ecin me hapa të ngadaltë dhe t'i mbajnë krahët hapur.

Për ta bërë më atraktive, tani detyra e nxënësve është që të ecin mbi litar dhe në dorë të mbajnë një tas të mbushur me ujë, kështu të provojnë ta kalojnë litarin.

**Hapi 3:** Nxënësit, të cilët e kalojnë litarin pa rënë në tokë, shpallen fitues.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për mënyrën e drejtqëndrimit të trupit në lojë.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

## Mësimi 9

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II

**Tema:** I lumtur dhe i shëndoshë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Zbaton pozicionet e sakta të drejtqëndrimit në pozitat ulur, në këmbë, në vend dhe në lëvizje.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; V.2,5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.


*Drejtqëndrimi - balancimi*

Gjatë ecjes dhe qëndrimit në një vend, si dhe gjatë lojërave apo aktiviteteve të ndryshme, trupi duhet të qëndrojë drejt.

*Ushtrime formimi - imitimi i kafshëve*

Disa ushtrime formimi ngjajnë me lëvizjet e kafshëve të ndryshme, që i njohim ose i kemi në shtëpi. P.sh., zgjatjet ngjajnë shumë me lëvizjet e maceve.

Shkruaj disa shembuj:

15

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ushtrime formimi - imitimi i kafshëve

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Bisedon për kafshën e preferuar;
- Praktikon lojën duke i imituar kafshët;
- Përshkruan me shembuj lëvizjet e kafshëve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Shkopinj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Hapet diskutimi me nxënësit duke i pyetur ata për kafshët e tyre të preferuara.
Diskutim rreth pyetjes:

- *Cila është kafsha juaj e preferuar?*

Përgjigje e mundshme: Luani, qeni, macja.



Drejtqëndrimi - balancimi

Gjatë ecjes dhe qëndrimit në një vend, si dhe gjatë lojërave apo aktiviteteve të ndryshme, trupi duhet të qëndrojë drejt.

Ushtrime formimi - imitimi i kafshëve

Disa ushtrime formimi ngjajnë me lëvizjet e kafshëve të ndryshme, që i njohim ose i kemi në shtëpi. P.sh., zgjatjet ngjajnë shumë me lëvizjet e maceve.

Shkruaj disa shembuj:

____________________________

____________________________

____________________________

15

**Hapi 2:** Nxënësit përshkruajnë me shembuj lëvizjet e kafshëve të ndryshme.

**Hapi 3:** Në mes të fushës vendosen disa shkop-inj si mur i improvizuar.

Nxënësit janë të rreshtuar te vija e startit dhe një nga një do ta kalojnë pengesën duke imituar kafshën e tyre të preferuar.

Kërcejnë shpejt ose ngadalë në pozita të ndryshme, përpiqen ta kapërcejnë këmbëmbledhur dhe bien me të dyja këmbët.

Gjatë kapërcimit, duhet pasur kujdes që të mos e prekin shkopin.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për përshkrimin me shembuj të lëvizjeve të kafshëve dhe lëvizjet e sakta gjatë imitimit të kafshëve.

**Detyrë:**

____________________________

____________________________

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

____________________________

## Mësimi 10

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II

**Tema:** I lumtur dhe i shëndoshë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Zbaton pozicionet e sakta të drejtqëndrimit në pozitat ulur, në këmbë, në vend dhe në lëvizje.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** III.1,5; V.2,8.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ecja e drejtë në traun e ulët dhe në vija të caktuara

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan pozitat e trupit në ecje;
- Diskuton për mënyrën e ecjes;
- Praktikon mënyrat e ecjes.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Litar, tase.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Hapi 1:** Kërkohet nga nxënësit të përshkruajnë pozitën e personazheve.
Diskutohet rreth pyetjes:
- *Pse personazhet i kanë krahët e hapur?*

Përgjigje e mundshme: Për ta mbajtur drejtqëndrimin.


*Ecja e drejtë në traun e ulët dhe në vija të caktuara*

Ecja nëpër tra apo nëpër vija tregon balancimin e trupit dhe ecjen e drejtë. Me duar të hapura anash, ecni nëpër vija të caktuara caktuara dhe, pastaj, me sy mbyllur, orientohuni kah shokët e klasës.

16

**Hapi 2:** Diksutohet me nxënësit për mënyrat e ecjes në traun gjimnastikor në vijat e caktuara. Pyeten nxënësit:

- *Si mbahet trupi për të ecur në tra?*

Përgjigje e mundshme: Duhet të mbajmë trupin drejt duke e balancuar.

- *Si duhet të mbahet trupit për të ecur në vijë të caktuar?*

Përgjigje e mundshme: Mbyllim sytë dhe dëgjojmë fjalët e shokut.

**Hapi 3:** Në dyshemen e fushës e vendosim litarin. Udhëzohen nxënësit që të ecin mbi litar dhe të provojnë ta mbajnë drejtqëndrimin - balancimin deri në fund të litarit.
Ata duhen të ecin me hapa të ngadaltë dhe t'i mbajnë krahët hapur.

Për ta bërë me atraktive, tani detyra e nxënësve është që të ecin mbi tra dhe në dorë të mbajnë një tas të mbushur me ujë, kështu të provojnë ta kalojnë traun.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit do të vlerësohen për përshkrimin dhe praktikën e mënyrave të ecjes.

**Detyrë:**

___

___

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

___

# Mësimi 11

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II

**Tema:** Kujdesi ndaj vetes dhe të tjerëve

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Aplikon ushtrime me elemente të hapësirës, të gjerësisë, të formës, të forcës, të shpejtësisë, të kohës dhe të ritmit të lëvizjes.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1; V.2,5,7.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.


*Ecja me duar dhe këmbë sipas kombinimit*

Rregulli kryesor është që nxënësi të mos lëvizë me dy pjesë të trupit njëkohësisht, d.m.th. një herë këmbën, pastaj dorën, e me radhë. Duke i kombinuar lëvizjet, ju mund ta kaloni lehtësisht hapësirën e caktuar.

17

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ecja me duar dhe këmbë sipas kombinimit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan për ecjen e kafshëve;
- Përcakton rregullin e lojës;
- Praktikon ecjen e koordinuar me lëvizje.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletë A4.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Hapi 1:** Hapet diskutimi së bashku me nxënësit rreth kafshëve.
Diskutim rreth pyetjes:
- *Si ecin kafshët?*

Përgjigje e mundshme: P.sh.: Me këmbë.


Ecja me duar dhe këmbë sipas kombinimit

Rregulli kryesor është që nxënësi të mos lëvizë me dy pjesë të trupit njëkohësisht, d.m.th. një herë këmbën, pastaj dorën, e me radhë. Duke i kombinuar lëvizjet, ju mund ta kaloni lehtësisht hapësirën e caktuar.

17

**Hapi 2:** Lexohet pjesa në tekst dhe përcaktohet rregulli i lojës gjatë ecjes.

Pyeten nxënësit:

- *Si duhet të lëvizin gjatë ecjes me duar dhe këmb?*

Përgjigje e mundshme: Rregulli kryesor është që mos të lëvizim me dy pjesë të trupit.

**Hapi 3:** Në disa fleta A4 printohen pëllëmbët e duarve dhe të këmbëve dhe ato vendosen në një vijë të drejtë.

Nxënësit janë të ndarë në dy grupe të barabarta. Duke i kombinuar lëvizjet, mund të kalohet lehtësisht hapësira e caktuar.

Loja mund të përsëritet disa herë.
Fiton ai grup që ka më pak gabime se grupi kundërshtar.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit do të vlerësohen për mënyrën e zbatimit të rregullit gjatë lojës.

**Detyrë:**

_______________________________________________

_______________________________________________

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

_______________________________________________

# Mësimi 12

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II
**Tema:** I lumtur dhe i shëndoshë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Aplikon ushtrime me elemente të hapësirës, të gjerësisë, të formës, të forcës, të shpejtësisë, të kohës dhe të ritmit të lëvizjes.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** IV.1,2,4,5; V.2,5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.


*Dëgjo rregullat!*

Rregullat janë disa detyra të vendosura nga prindërit, mësuesi/ja apo nga ju, për veten ose klasën në përgjithësi.

Rregulla kanë të gjitha lojërat që i luajmë në shkollë, shtëpi apo në lagje, por rregulla kanë edhe sportet, si: futbolli, basketbolli, volejbolli, hendbolli etj.

Shkruaj 3 rregulla që i zbatoni në shtëpi, 3 që kërkohen të zbatohen nga mësuesi/ja në shkollë dhe 4 rregulla vendosni ju për veten:

1 ______
2 ______
3 ______
4 ______
5 ______
6 ______
7 ______
8 ______
9 ______
10 ______

18

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Dëgjo rregullat!

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Bisedon për rregullat e shtëpisë;
- Përcakton rregullat e sporteve të ndryshme;
- Formulon së paku tri rregulla të ndryshme.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libër.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Hapi 1:** Diskutim me nxënësit rreth pyetjes:

- *Cilat janë rregullat tuaja në shtëpi?*



Dëgjo rregullat!

Rregullat janë disa detyra të vendosura nga prindërit, mësuesi/ja apo nga ju, për veten ose klasën në përgjithësi.

Rregulla kanë të gjitha lojërat që i luajmë në shkollë, shtëpi apo në lagje, por rregulla kanë edhe sportet, si: futbolli, basketbolli, volejbolli, hendbolli etj.

Shkruaj 3 rregulla që i zbatoni në shtëpi, 3 që kërkohen të zbatohen nga mësuesi/ja në shkollë dhe 4 rregulla vendosni ju për veten:

1 ____________________
2 ____________________
3 ____________________
4 ____________________
5 ____________________
6 ____________________
7 ____________________
8 ____________________
9 ____________________
10 ____________________

18

**Hapi 2:** Diskutohet më nxënësit për rregullat e sporteve të ndryshme.

U bëhen pyetje se si luhet futbolli dhe cilat janë disa nga rregullat për lojën e futbollit.

Pastaj nxënësit pyeten për disa rregulla të lojërave të ndryshme, si: të basketbollit, vojebollit dhe të hendbollit.

**Hapi 3:** Nxënësve u kërkohet që në tabelën e paraqitur t'i shkruajnë së paku tri rregulla për veten. Rregullat mund të jenë rreth disiplinës dhe rreth punës në shkollë.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit do të vlerësohen për formulimin e saktë të rregullave të ndryshme.

**Detyrë:**

_______________________________________

_______________________________________

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:* ____________________

_______________________________________

# Mësimi 13

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE




**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II
**Tema:** I lumtur dhe i shëndoshë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Respekton rregullat dhe udhëzimet e sigurta gjatë lojërave, gjatë aktiviteteve apo gjatë përdorimit të mjeteve, të rekuizitave dhe të pajisjeve të ndryshme.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** V.2,5,7.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** "Shishet e rrëzuara"

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan sportin e paraqitur;
- Përcakton rregullat e lojës;
- Praktikon lojën me rregulla.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Para nxënësve paraqiten shishet e boulingut.

Nxënësit pyeten se çfarë sporti është ky dhe më pas diskutohet më nxënësit.


"Shishet e rrëzuara"

Me top do t'i rrëzojmë shishet e vendosura përballë, në një largësi prej 5 m. Shishet largohen pasi të rrëzohen dhe kështu veprohet deri të rrëzohen të gjitha.

19

**Hapi 2:** Lexohet pjesa në tekst dhe përcakohet rregulli i lojës.
Pyeten nxënësit:

- *Cili është rregulli i lojës?*

*P*ërgjigje e mundshme: Shishet vendosen në largësi 5 m për të realizuar gjuajtjen.

**Hapi 3:** Nxënësit ndahen në dy grupe të barabarta dhe vendosen në kolona. Shishet e boulingut janë të vendosura 5 metra larg të dyja grupeve. Secili nxënës i grupit do të gjuajë nga një herë dhe do të përpiqet të rrëzojë sa më shumë shishe. Nxënësit do të gjuajnë me radhë, një herë nxënësi i njërit grup, pastaj i grupit tjetër.

Caktohen dy nxënës te shishet që ta luajnë rolin e gjyqtarit dhe i numërojnë pikët.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për respektimin e largësisë gjatë gjuajtjes.

**Detyrë:**

___

___

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 14

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II
**Tema:** I lumtur dhe i shëndoshë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Demonstron shkathtësi fizike gjatë aktiviteteve psikomotorike, si: pasim, gjuajtje, hedhje me dorë, me këmbë etj.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** V.2, 5, 7.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.


*Cili është grupi më i shpejtë?*

Me udhëheqjen e mësuesit/es, nxënësit i marrin me radhë topat një nga një dhe i fusin në shportën përballë.

*"Lexo dhe vepro"*

Grupet e nxënësve kanë për detyrë: një nxënës të vrapojë, ta marrë një letër, ta sjellë te grupi i vet dhe ta lexojë me zë. Nxënësit duhet ta realizojnë veprimin që shkruhet në atë letër. Kështu veprojnë të gjithë, derisa të gjitha letrat të harxhohen.

20

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Cili është grupi më i shpejtë?

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Klasifikon topin sipas sportit përkatës;
- Përcakton rregullat e lojës;
- Praktikon lojën sipas rregullave.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Topa të ndryshëm.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Para nxënësve paraqiten disa topa të sporteve të ndryshme dhe pyeten nxënësit se cilit sport i përket secili top.





*Cili është grupi më i shpejtë?*

Me udhëheqjen e mësuesit/es, nxënësit i marrin me radhë topat një nga një dhe i fusin në shportën përballë.

*"Lexo dhe vepro"*

Grupet e nxënësve kanë për detyrë: një nxënës të vrapojë, ta marrë një letër, ta sjellë te grupi i vet dhe ta lexojë me zë. Nxënësit duhet ta realizojnë veprimin që shkruhet në atë letër. Kështu veprojnë të gjithë, derisa të gjitha letrat të harxhohen.

20

**Hapi 2:** Lexohet pjesa në libër dhe përcakohen rregullat e lojës.
Pyeten nxënësit:

- *Si do të luajmë?*

Përgjigje e mundshme: Lojën do ta luajmë sipas radhës duke i vendosur topat në shportë sipas largësisë 10 m.

**Hapi 3:** Nxënësit ndahen në dy grupe të barabarta, ndërsa ata që janë vendosur të parët në rresht e fillojnë lojën.
Në një distancë prej 10 metrash përballë tyre, vendosen dy shporta, ndërsa nëpër fushë shpërndahen disa topa.
Detyra e nxënësve është të mbledhin sa më shumë topa dhe t'i fusin në shportë.

Sa topa të mbledhin, aq pikë fiton grupi. Në fund të lojës mblidhen pikët dhe shpallet grupi fitues.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për zbatimin e rregullit gjatë lojës.

**Detyrë:**

______________________________

______________________________

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:* ______________________________

______________________________

## Mësimi 15

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II
**Tema:** I lumtur dhe i shëndoshë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Respekton rregullat dhe udhëzimet e sigurta gjatë lojërave, gjatë aktiviteteve apo gjatë përdorimit të mjeteve, të rekuizitave dhe të pajisjeve të ndryshme.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** IV.5; V.2,5,7.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.


*Cili është grupi më i shpejtë?*

Me udhëheqjen e mësuesit/es, nxënësit i marrin me radhë topat një nga një dhe i fusin në shportën përballë.

*"Lexo dhe vepro"*

Grupet e nxënësve kanë për detyrë: një nxënës të vrapojë, ta marrë një letër, ta sjellë te grupi i vet dhe ta lexojë me zë. Nxënësit duhet ta realizojnë veprimin që shkruhet në atë letër. Kështu veprojnë të gjithë, derisa të gjitha letrat të harxhohen.

20

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** "Lexo dhe vepro"

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Rendit shkronjat për të formuar fjalën;
- Përcakton rregullat e lojës;
- Praktikon lojën me letra.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Letra.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Kërkohet nga nxënësit që shkronjat me E, T , A, L, R të renditen duke formuar fjalën.
Pyetje:
- *Cila fjalë mund të formohet nga këto shkronja?*

Përgjigje e mundshme: Është fjala letra.



*Cili është grupi më i shpejtë?*

Me udhëheqjen e mësuesit/es, nxënësit i marrin me radhë topat një nga një dhe i fusin në shportën përballë.

*"Lexo dhe vepro"*

Grupet e nxënësve kanë për detyrë: një nxënës të vrapojë, ta marrë një letër, ta sjellë te grupi i vet dhe ta lexojë me zë. Nxënësit duhet ta realizojnë veprimin që shkruhet në atë letër. Kështu veprojnë të gjithë, derisa të gjitha letrat të harxhohen.

20

**Hapi 2:** Lexohet teksti dhe përcakohen rregullat e lojës.

*Rregullat e lojës:*

*Vrapo merr letrën;*
*Eja te grupi dhe lexo;*
*Bëj veprimin e kërkuar në letër.*

**Hapi 3:** Nxënësit ndahen në dy grupe të barabarta. Fillojnë me radhë, njëri nxënës vrapon e merr një letër e sjell te grupi i tij dhe e lexon me zë. Të tjerët duhet ta bëjnë veprimin që shkruhet në letër. Kështu do të veprojnë të gjithë nxënësit, gjersa të harxhohen letrat.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit do të vlerësohen për respektimin e rregullave të lojës sipas kërkesës së shkruar.

**Detyrë:**

---

---

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---

# Mësimi 16

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II
**Tema:** I lumtur dhe i shëndoshë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Respekton rregullat dhe udhëzimet e sigurta gjatë lojërave, gjatë aktiviteteve apo gjatë përdorimit të mjeteve, të rekuizitave dhe të pajisjeve të ndryshme.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** V.2,5,7.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.


*Pasimi i topit nga pozita të ndryshme*

Të vendosur përballë njëri-tjetrit, pasoni me topa nga të gjitha pozitat: pasimi nga gjoksi, mbi kokë dhe me përplasje për tokë, me një dhe dy duar. Kohë pas kohe e ndërroni bashkëlojtarin.

*Hedhja (shtytja) e topit me një dorë*

Të vendosur përballë njëri-tjetrit në një distancë jo më shumë se 5 m, pasoni topin me një dorë dhe me dy duar sa më larg. Kohë pas kohe e ndërroni bashkëlojtarin.

21

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Pasimi i topit nga pozita të ndryshme

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Rendit fjalët për të formuar fjali;
- Përcakton rregullat e lojës;
- Praktikon gjuajtjet në pozita të ndryshme.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Top basketbolli.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Hapi 1:** Kërkohet nga nxënësit që t'i renditin fjalët për të formuar fjali.

*pozita* *me* *nga* *Pasojmë* *top* *të ndryshme*

Përgjigje e mundshme: Pasojmë me top nga pozita të ndryshme.
Lexohen disa nga fjalitë që janë renditur nga nxënësit.



*Pasimi i topit nga pozita të ndryshme*

Të vendosur përballë njëri-tjetrit, pasoni me topa nga të gjitha pozitat: pasimi nga gjoksi, mbi kokë dhe me përplasje për tokë, me një dhe dy duar. Kohë pas kohe e ndërroni bashkëlojtarin.

*Hedhja (shtytja) e topit me një dorë*

Të vendosur përballë njëri-tjetrit në një distancë jo më shumë se 5 m, pasoni topin me një dorë dhe me dy duar sa më larg. Kohë pas kohe e ndërroni bashkëlojtarin.

21

**Hapi 2:** Lexohet teksti në libër dhe përcaktohen rregullat e lojës.

*Rregullat e lojës:*

*- Rreshtohu përballë njëri-tjetrit;*
*- Paso topin sipas:*
*- pasimit në gjoks,*
*- pasimit në kokë,*
*- pasimit me përplasje për tokë.*

**Hapi 3:** Nxënësit ndahen në çifte dhe rreshtohen përgjatë vijës së fushës. Secili çift ka nga një top. Detyra e nxënësve është që të pasojnë topin te bashkushtruesi. Pasohet topi nga pozita të ndryshme. Një herë pasohet topi nga gjoksi në drejtim të bashkushtruesit, pastaj pasohet topi mbi kokë dhe pastaj pasohet me dëbim nga toka. Vazhdohet kështu deri në përfundim të lojës.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për mënyrën e pasimit të topit sipas pozitave të ndryshme.

**Detyrë:**

---

---

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---

---

# Mësimi 17

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II
**Tema:** Aktivitetet psikomotorike dhe koordinimi i tyre

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Respekton rregullat dhe udhëzimet e sigurta gjatë lojërave, gjatë aktiviteteve apo gjatë përdorimit të mjeteve, të rekuizitave dhe të pajisjeve të ndryshme.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** V.2,5,7.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.



*Pasimi i topit nga pozita të ndryshme*

Të vendosur përballë njëri-tjetrit, pasoni me topa nga të gjitha pozitat: pasimi nga gjoksi, mbi kokë dhe me përplasje për tokë, me një dhe dy duar. Kohë pas kohe e ndërroni bashkëlojtarin.

*Hedhja (shtytja) e topit me një dorë*

Të vendosur përballë njëri-tjetrit në një distancë jo më shumë se 5 m, pasoni topin me një dorë dhe me dy duar sa më larg. Kohë pas kohe e ndërroni bashkëlojtarin.

21

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Hedhja (shtytja) e topit me një dorë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përcakton rregullat e lojës;
- Praktikon hedhjen e topit në largësinë e caktuar.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Top.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Lexohet teksti dhe së bashku me nxënësit përcaktojmë rregullat e lojës.

*Vendosuni përballë njëri-tjetrit;*
*Mbaj largësinë nga 5 m;*
*Ndërro lojtarët kohë pas kohe.*


Pasimi i topit nga pozita të ndryshme

Të vendosur përballë njëri-tjetrit, pasoni me topa nga të gjitha pozitat: pasimi nga gjoksi, mbi kokë dhe me përplasje për tokë, me një dhe dy duar. Kohë pas kohe e ndërroni bashkëlojtarin.

Hedhja (shtytja) e topit me një dorë

Të vendosur përballë njëri-tjetrit në një distancë jo më shumë se 5 m, pasoni topin me një dorë dhe me dy duar sa më larg. Kohë pas kohe e ndërroni bashkëlojtarin.

21

**Hapi 2:** Nxënësit vendosen përballë njëri-tjetrit dhe në dorë mbajnë një top. Distanca e nxënësve do të jetë jo më shumë se 5 m. Ata do ta pasojnë topin me një dorë, sa më larg, deri te nxënësi përballë.

**Hapi 3:** Loja mund të përsëritet disa herë.
Ai, i cili e hedh më së shumti herë topin në shportë, shpallet fitues.



**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit do të vlerësohen për largësinë e hedhjes së topit me një dorë.

**Detyrë:**

______________________________

______________________________

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

______________________________

# Mësimi 18

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II
**Tema:** Aktivitetet psikomotorike dhe koordinimi i tyre

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Nxënësit vendosen në kolonë, duke qëndruar në duar dhe këmbë. Dy nxënës të tjerë ndahen, njëri në anën e djathtë, tjetri në të majtën dhe pasojnë me top përfundi trupit të shokëve në kolonë. Kujt i kalon topi, ikën me vrap në fund dhe vendoset në kolonë prapë.

46

të shokëve në kolonë.
Kujt i kalon topi, ikën me vrap në fund dhe vendoset në kolonë.

**Hapi 3:** Bisedohet me nxënësit për vështirësitë që kishin gjatë lojës. Pyeten:

- *Çfarë vështirësie kishit gjatë lojës?*

Përgjigje e mundshme: Të qëndroj me duar lart pa u mbështetur.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit do të vlerësohen për shkathtësi e shpejtësi në lëvizje.

**Detyrë:**

________________________________________

________________________________________

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:* ____________________

________________________________________

# Mësimi 63

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II
**Tema:** Lojërat lëvizore dhe rëndësia e pushimit aktiv

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Demonstron shkathtësi fizike gjatë aktiviteteve psikomotorike, si: pasim, gjuajtje, hedhje me dorë, me këmbë etj.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** IV.5; V.2,5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** "Qëllo në shenjë"

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Rikujton veprimin matematikor të mbledhjes;
- Praktikon lojën në hedhje të gurit;
- Diskuton për vështirësitë gjatë lojës.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fleta A4, gurë ose toptha.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Në fillim të orës mësimore nxënësit testohen nga lënda e matematikës rreth mbledhjes së numrave dyshifrorë.
Më pas njoftohen me lojën që ka të bëjë me numra.
Nxënësit udhëzohen të zgjidhin detyrën me mbledhje duke rikujtuar veprimin matematikor.
10+20 20+20
Përgjigje e mundshme: 30, 40.


"Qëllo në shenjë!"

Në tokë vendosen disa shënjestra, të cilat kanë pikët e veta. Nxënësit hedhin gurin afër shënjestrës nga 3 herë dhe i mbledhin pikët. Fiton kush ka më shumë pikë.



47

**Hapi 2:** Në 5 fleta A4 të bardha shënohen numrat 10, 20, 30, 40 dhe 50. Fletat vendosen në tokë në një vijë të drejtë duke filluar nga numri 10.

Detyra e nxënësve është që ta hedhin gurin afër shënjestrës nga tri herë dhe t'i mbledhin pikët.

Qëllimi i nxënësve është që ta hedhin gurin sa më afër numrit të madh, që të fitojnë më shumë pikë.

Në fund i mbledhim pikët e grumbulluara nga ana e nxënësve.

Ai që ka grumbulluar më së shumti pikë, është fituesi i lojës.

**Hapi 3:** Diskutohet me nxënës pas lojës për vështirësitë që kishin. Pyeten:

- *Cila ishte vështirësia e lojës?*

Përgjigje e mundshme: Ishte e vështirë mbledhja e numrave dyshifror me shpejtësi.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit do të vlerësohen për mënyrën e zgjidhjes së detyrës dhe saktësinë në hedhjen e gurit.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 64

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II
**Tema:** Ushqimi i shëndetshëm dhe shprehitë e të ushqyerit

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Diskuton për shprehitë e shëndetshme të të ushqyerit.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; III.2; V.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,3,5.


*Cili është ushqimi i shëndetshëm?*

Shkruaj se me çfarë ke dëshirë të rrethohet shtëpia juaj, duke tërhequr një shigjetë drejt shtëpisë.

Plotëso fjalitë me fjalët: e shëndetshme dhe jo e shëndetshme.

1. Kur pimë ujë është ______________.
2. Dreka ime më e mirë është ushqimi me perime. ___________
3. Ëmbëlsirat i hamë gjithnjë para drekës. ____________
4. Frutat mund t'i hamë edhe pa i larë. ________________
5. Perimet dhe frutat kanë shumë vitamina. ____________
6. Ushqimi i shpejtë është ______________________.

52

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Cili është ushqimi i shëndetshëm?

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Diskuton për ushqimet në fotografi;
- Përzgjedh ushtrimin e preferuar;
- Plotëson pyetjet sipas vlerësimit personal.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teksti, fotografi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Hapi 1:** Para nxënësve paraqiten dy fotografi, të cilat shikohen me vëmendje dhe diskutohet:

- *Cila mund të jetë dilema e djaloshit në fotografi?*





Përgjigje e mundshme: Çka të hajë.

- *Cilën rrugë do ta zgjidhnit ju?*

Përgjigje e mundshme: Mollë.



*Cili është ushqimi i shëndetshëm?*

Shkruaj se me çfarë ke dëshirë të rrethohet shtëpia juaj, duke tërhequr një shigjetë drejt shtëpisë.

Plotëso fjalitë me fjalët: e shëndetshme dhe jo e shëndetshme.

1. Kur pimë ujë është ______________.
2. Dreka ime më e mirë është ushqimi me perime. ___________
3. Ëmbëlsirat i hamë gjithnjë para drekës. ____________
4. Frutat mund t'i hamë edhe pa i larë. ________________
5. Perimet dhe frutat kanë shumë vitamina. ____________
6. Ushqimi i shpejtë është ______________________.

52

**Hapi 2:** Vëzhgohen figurat në libër.
Nxënësit udhëzohen t'i lidhin me shigjetë ushqimet.

Detyra plotësohet përmes pyetjeve:
*1. Trego për të mirat që kanë frutat dhe perimet.*

Bëhet lidhja e ushqimeve dhe nxënësit i komentojnë me shokun e bankës ushqimet e përzgjedhura.

**Hapi 3:**
Nxënësit do të plotësojnë pyetjet e parashtruara në libër përmes dy fjalëve: *e shëndetshme* dhe *jo e shëndetshme.*

1. Kur pimë ujë është ___________(e shëndetshme)
2. Ëmbëlsirat i hamë gjithnjë para drekës_________(jo e shëndetshme)

Shkruhen në libër dhe lexohen më pas.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit do të vlerësohen për përzgjedhjen e ushqimit të shëndetshëm dhe përgjigjet e dhëna në libër.

**Detyrë:**

______________________________________________

______________________________________________

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:* ______________________________________________

______________________________________________

# Mësimi 65

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II
**Tema:** Ushqimi i shëndetshëm dhe shprehitë e të ushqyerit

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Zbaton praktikat higjienike para, gjatë dhe pas ushqimit.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; III.2,7; V.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,3,5.


*Higjiena para dhe pas ushqimit*

Diskuto me shokët dhe mësuesin/en për mënyrën se si e mbani higjienën para dhe pas ushqimit.

Duart duhen pastruar gjithmonë:

1. para dhe pas ushqimit;
2. pas shkuarjes në tualet;
3. pas teshtimës, kollës, fshirjes së hundës;
4. pas prekjes së kafshëve;
5. pas hedhjes së mbeturinave.

51

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Higjiena para dhe pas ushqimit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shpreh një mendim për fjalinë e dhënë;
- Diskuton për mbajtjen e higjienës;
- Rendit veprimet në fjali sipas fishave.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teksti shkollor, fisha.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Hapi 1:** Shkruhet në tabelë një pyetje:

*Pse është e rëndësishme larja e duarve?*

Kërkohet nga nxënësit të japin një mendim. Diskutimi drejtohet gjithmonë në anën e higjienës.

**Hapi 2:** Vëzhgohet figura në libër ku paraqiten duart e lara me ujë dhe me pastrues (shampon, sapun).

Pyeten nxënësit:

- *Sa herë i pastroni duart gjatë ditës?*



Higjiena para dhe pas ushqimit

Diskuto me shokët dhe mësuesin/en për mënyrën se si e mbani higjienën para dhe pas ushqimit.

Duart duhen pastruar gjithmonë:

1. para dhe pas ushqimit;
2. pas shkuarjes në tualet;
3. pas teshtimës, kollës, fshirjes së hundës;
4. pas prekjes së kafshëve;
5. pas hedhjes së mbeturinave.

51

- *Pas cilit veprim mendoni që është e rëndësishme t'i pastroni menjëherë duart?*

Përgjigjet e mundshme: Duart i pastroj disa herë në ditë. Është e rëndësishme t'i pastrojmë duart menjëherë pas prekjes së dyshemes.

**Hapi 3:** Ndahen nxënësit në grupe.
Atyre u shpërndahen fisha me fjalë. Kërkohet t'i rendisin saktë fjalët.

*laj gjithmonë teshtimës pas duart*

*së kafshëve laj gjithmonë pas prekjes duart*

Grupi që rendit saktë, paraqet dhe lexon punën para klasës.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për renditjen e saktë të fjalëve dhe diskutimin për mbajtjen e higjienës së duarve.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 66

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II
**Tema:** Ushqimi i shëndetshëm dhe shprehitë e të ushqyerit

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Zbaton praktikat higjienike para, gjatë dhe pas ushqimit.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; III.2,7; V.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,3,5.


*Si i pastrojmë frutat dhe perimet?*

Frutat pastrohen me ujë, por ndryshe nga njëra-tjetra dhe ju do të na ndihmoni t'i pastrojmë disa.
Shkruani me fjalë si pastrohen frutat dhe perimet.

Mollët pastrohen duke________________________

Dredhëzat ________________________________

Rrushi______________________

53

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Si i pastrojmë frutat dhe perimet?

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Tregon për pastrimin e frutave;
- Dallon mënyrat e pastrimit të frutave;
- Shpjegon larjen e frutave ose perimeve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teksti, fotografi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nga nxënësit kërkohet të tregojnë për veprimin që bëjnë para konsumimit të frutave.

- *Cili është veprimi që bëni para se të hani një frutë?*

Përgjigje e mundshme: Fruta në fillim lahet, më pas konsumohet.

- *Si duhet ta pastrojmë mollën dhe si rrushin?*

Përgjigje e mundshme: Molla lahet me të dyja duart dhe me ujë të bollshëm, ndërsa rrushi lihet të qëndrojë në ujë gjatë.

Nxënësit shprehin mendimet e tyre.


*Si i pastrojmë frutat dhe perimet?*

Frutat pastrohen me ujë, por ndryshe nga njëra-tjetra dhe ju do të na ndihmoni t'i pastrojmë disa.
Shkruani me fjalë si pastrohen frutat dhe perimet.

Mollët pastrohen duke________________________

Dredhëzat ________________________________

Rrushi______________________

53

**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen të shkruajnë si pastrohen frutat e dhëna në figurë.
Plotësimi bëhet përmes pyetjeve:

- *Si pastrohet molla?*
- *Po dredhëzat dhe rrushi, si pastrohen?*
- *Ku qëndron dallimi në larje të frutave?*

Nxënësit shkruajnë në vijat e zbrazëta përgjigjen e saktë.

**Hapi 3:** Ndahen nxënësit në grupe. 

Atyre u shpërndahen fotografi ku shihet një frutë ose një perime.

Ata do të diskutojnë në grup për mënyrën e larjes së saj dhe do të dalin më një përgjigje grupore.

P.sh. speci i kuq lahet në tërësi nën çezmën e ujit.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për dallimin në larjen e frutave dhe perimeve.

**Detyrë:**

_______________________________________________

_______________________________________________

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:* ________________________

_______________________________________________

## Mësimi 67

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II
**Tema:** Ushqimi i shëndetshëm dhe shprehitë e të ushqyerit

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon vlerat ushqyese të produkteve që konsumon.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; III.2; V.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,3,5.



Vlerat e frutave

Përfitime shëndetësore sigurohen duke ngrënë fruta. Frutat janë përgjithësisht të pasura me fibra, ujë, vitaminë C dhe sheqer natyral. Frutat kanë gjithashtu pak kalori. Ato kanë vlera ushqyese dhe janë aleat i fortë i shëndetit.

MOLLA: Përmban vitaminat C, PP, B1, B2, A dhe minerale kalciumi, magnezi, ujë, proteina, shumë pak yndyrë, sheqer të disa llojeve, fibra e kripë.

DARDHA: Përmban vitaminat C, K, B2, B3, B6 dhe mineralet: kalcium, magnez, kalium, bakër dhe mangan.

BANANIA: Përmban vitaminat A, B1, B2, B6, C, E, K dhe mineralet: kalium, fosfor, magnez, kalcium, hekur, bakër, zink.

55

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vlerat e frutave

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Diskuton për frutat dhe përmbajtjen e tyre;
- Dallon frutat sipas vlerave ushqyese;
- Vendos fjalën në frutën përkatëse.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teksti, fletë A4, fotografi, fisha.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Me nxënësit diskutohet për frutat dhe përmbajtjen e tyre.

- *Çfarë dini për frutat?*

Përgjigje e mundshme: Janë të shëndetshme, të ëmbla etj.

- *Çfarë përmbajnë ato?*

Përgjigje e mundshme: Vitamina, ujë, minerale etj.

Diskutohet për përbërjen e frutave dhe për përfitimet që kemi nga to, veçanërisht në forcimin e imunitetit tonë.
Vihet në një përfundim që: *Frutat janë aleat i fortë i shëndetit.*


*Vlerat e frutave*

Përfitime shëndetësore sigurohen duke ngrënë fruta. Frutat janë përgjithësisht të pasura me fibra, ujë, vitaminë C dhe sheqer natyral. Frutat kanë gjithashtu pak kalori. Ato kanë vlera ushqyese dhe janë aleat i fortë i shëndetit.

MOLLA: Përmban vitaminat C, PP, B1, B2, A dhe minerale kalciumi, magnezi, ujë, proteina, shumë pak yndyrë, sheqer të disa llojeve, fibra e kripë.

DARDHA: Përmban vitaminat C, K, B2, B3, B6 dhe mineralet: kalcium, magnez, kalium, bakër dhe mangan.

BANANIA: Përmban vitaminat A, B1, B2, B6, C, E, K dhe mineralet: kalium, fosfor, magnez, kalcium, hekur, bakër, zink.

55

**Hapi 2:** Lexohet teksti ku nxënësit udhëzohen përmes figurave të dallojnë frutat sipas vlerave ushqyese.

- *Çfarë mendoni që përmban molla?*

Përgjigje e mundshme: Vitamin C.
Komentohet nga nxënësit, më pas lexohet në libër përgjigjja e saktë.

- *Po dardha,* për dallim nga molla?

Përgjigje e mundshme: Ujë, vitamina, bakër.
Prapë komentohet nga nxënësit, më pas lexohen të dhënat e sakta në libër.

Kështu vazhdohet edhe me frutën e fundit bananen.

**Hapi 3:** Nxënësit ndahen në grupe.
Ata do të diskutojnë së bashku duke gjetur përmbajtjen e saktë të frutave dhe në tabelë vendosin fishat me fjalë apo shkronjë përkatëse për frutën.

P.sh.: Molla (C, B2, A, magnez etj.). Dardha (C, K, B2, kalium etj.). Banania (A, B1, B2, fosfor etj.).

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për dallimin e frutave sipas vlerave ushqyese dhe vendosjen e saktë të fjalisë në tabelë.

**Detyrë:**

Vazhdoni të shkruani për disa fruta që ju pëlqejnë.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

## Mësimi 68

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II
**Tema:** Mbrojtja dhe siguria nga rreziqet e ndryshme

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Tregon për rëndësinë e medikamenteve dhe rreziqet nga përdorimi i barnave, substancave, preparateve, pajisjeve të ndryshme për jetën e tyre.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; III.2; V.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,3,5.


*Rëndësia e barnave*

Barnat te fëmijët ndikojnë ndryshe prej të rriturve. Të rriturit shpesh marrin medikamente kundër shqetësimeve të lehta, si dhembjet e kokës, kolla, teshtima etj., por barna të tilla nuk ndikojnë njësoj te fëmijët, pasi zhvillimi i tyre ende nuk ka përfunduar. Për këtë shkak, pa një këshillë profesionale nga farmacistët ose mjekët dhe pa një lexim të saktë të udhëzimeve përcjellëse në paketim, nuk duhet t'i konsumojmë. Kujdes! Barna të caktuara kanë ndikim të dëmshëm te fëmijët.

60

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Rëndësia e barnave

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon mjetet që gjenden në kuti;
- Përshkruan veprimin e personit;
- Improvizon në role profesionet.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Kuti me barna.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Në klasë do të sillet një kuti me barna të ndryshme. Pyeten:

- *Çfarë ka në kuti?*

Përgjigje e mundshme: Barna.

- *Kush i përdor barnat?*

Përgjigje e mundshme: Njerëzit që kanë probleme me shëndetin.



*Rëndësia e barnave*

Barnat te fëmijët ndikojnë ndryshe prej të rriturve. Të rriturit shpesh marrin medikamente kundër shqetësimeve të lehta, si dhembjet e kokës, kolla, teshtima etj., por barna të tilla nuk ndikojnë njësoj te fëmijët, pasi zhvillimi i tyre ende nuk ka përfunduar. Për këtë shkak, pa një këshillë profesionale nga farmacistët ose mjekët dhe pa një lexim të saktë të udhëzimeve përcjellëse në paketim, nuk duhet t'i konsumojmë. Kujdes! Barna të caktuara kanë ndikim të dëmshëm te fëmijët.

60

**Hapi 2:** Udhëzohen nxënësit të shikojnë në libër personazhin në fotografi.
Pyeten:

- *Çfarë mendimi keni për vajzën?*

Përgjigje e mundshme: Përdorimi i barnave pa recetë është i ndaluar.

Nxënësit mësohen që përdorimi i barnave pa recetë të mjekut është i ndaluar.

**Hapi 3:** Nxënësit ndahen në role dhe improvizojnë shitjen e barnave në barnatore.

*Shembull:*
Farmacisti: Përshendetje!
Bleresi: Përshendetje! Erdha të blej shurup për kollë.
Farmacisti: Ma trego recetën e mjekut.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për përshkrimin e veprimit të farmacistit dhe improvizimin në role.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 69

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II
**Tema:** Mbrojtja dhe siguria nga rreziqet e ndryshme

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Tregon për rëndësinë e medikamenteve dhe rreziqet nga përdorimi i barnave, substancave, preparateve, pajisjeve të ndryshme për jetën e tyre.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.4; III.3; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.


*Rreziku nga barnat*

Pjesa më e madhe e sëmundjeve të lehta të fëmijërisë shërohen vetë, pa nevojën e asnjë bari. Nëse duhet dhënë një bar, do të jetë mjeku/ja që do t`ju këshillojë si ta përdorni: sa herë në ditë dhe për sa kohë duhet ta merrni. Duhet të ndiqni me kujdes udhëzimet e tij/saj. Në rast se mjeku/ja ju jep një cikël antibiotikësh që duhen dhënë për një javë apo 5 ditë, edhe nëse ju duket se pas 3 ditëve jeni mirë, mos e ndërprisni pirjen e tyre, sepse infeksioni mund të rikthehet.

61

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Rreziku nga barnat

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Flet për përdorimin e barnave;
- Diskuton për këshillat e mjekut;
- Shpjegon për rëndësinë e barnave.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Kuti me barna.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Në klasë sillen disa lloje të barnave dhe u tregohen nxënësve.
Pyeten:

- *Kur keni qenë të sëmurë, çfarë keni bërë?*

Përgjigje e mundshme: Kemi përdorur barna, kemi shkuar te mjeku.
Pjesa më e madhe e sëmundjeve të lehta të fëmijërisë shërohen vetvetiu.



Rreziku nga barnat

Pjesa më e madhe e sëmundjeve të lehta të fëmijërisë shërohen vetë, pa nevojën e asnjë bari. Nëse duhet dhënë një bar, do të jetë mjeku/ja që do t`ju këshillojë si ta përdorni: sa herë në ditë dhe për sa kohë duhet ta merrni. Duhet të ndiqni me kujdes udhëzimet e tij/saj. Në rast se mjeku/ja ju jep një cikël antibiotikësh që duhen dhënë për një javë apo 5 ditë, edhe nëse ju duket se pas 3 ditëve jeni mirë, mos e ndërprisni pirjen e tyre, sepse infeksioni mund të rikthehet.

61

**Hapi 2:** Diskutimi vazhdon dhe ata pyeten prapë:

- *A duhet të përdoren barnat pa këshillën e mjekut?*

Përgjigje e mundshme: Jo.

Nëse duhet dhënë një bar, mjeku do t'ju këshillojë si ta përdorni, sa herë në ditë dhe për sa kohë duhet ta merrni.

**Hapi 3:** Nxënësit nxiten që gjatë diskutimit të shpjegojnë për rëndësinë e barnave. Pyeten ata:

- *Çfarë rëndësie kanë barnat në jetën tonë?*

Përgjigje e mundshme: Barnat na shërbejnë kur jemi të sëmurë. Barnat na dëmtojnë kur i përdorim pa pasur nevojë.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit do të vlerësohen gjatë diskutimit për këshillat e mjekut dhe rëndësisë së barnave.

**Detyrë:**

___

___

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:* ___

___

# Mësimi 70

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II
**Tema:** Kujdesi për mjedisin

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Diskuton për faktorët e mjedisit të jashtëm që ndikojnë në rritjen dhe në zhvillimin e tij/saj.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.4; IV.3; V.3,5; VI.2,5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mjedisi i jashtëm

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Diskuton për mjedisin e jashtëm ku jeton;
- Përshkruan mjedisin e pastër ku jeton;
- Arsyeton gjendjen e mjedisit ku banon.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Udhëzohen nxënësit të diskutojnë se si duket mjedisi i jashtëm ku ata jetojnë.
Pyeten nxënësit:
- *A kujdeseni ju për mjedisin e jashtëm në lagjen ku banoni?*

Përgjigje e mundshme: Po, ndonjëherë kujdesem unë, babi ose motra.

**Hapi 2:** Udhëzohen nxënësit që të shikojnë në libër.
Diskutimi vazhdon me pyetjen:

- *Me çfarë është e rrethuar shtëpia juaj?*

Përgjigje e mundshme: Me pemë, me lule.


Mjedisi i jashtëm

Shkruaj se me çfarë ke dëshirë të rrethohet shtëpia jote, duke tërhequr një shigjetë drejt shtëpisë.



64

Nxënësit udhëzohen të shkruajnë për rrethinën e shtëpisë së tyre, më pas i plotësojnë ato në libër sipas kërkesës.

Detyra e nxënësve është që të shkruajnë se me çfarë kanë dëshirë të rrethohet shtëpia e tyre, duke tërhequr një shigjetë drejt shtëpisë.

**Hapi 3:** Nxënësit lexojnë punimet dhe e arsyetojnë gjendjen e mjedisit që e rrethojnë.

Përgjigje e mundshme: *Shtëpia ime ka shumë gjelbërim dhe ajër të pastër.*

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit do të vlerësohen për përshkrimin e mjedisit ku banon dhe arsyetimin e gjendjes së tij.

**Detyrë:**

________________________________________

________________________________________

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

________________________________________

________________________________________

# Mësimi 71

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II
**Tema: Kujdesi për mjedisin**

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Zbaton rregullat elementare të mbajtjes pastër të mjedisit që e rrethon.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.4; IV.3; V.3,5; VI.2,5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ta mbajmë mjedisin të pastër!

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon figurën sipas karakteristikave;
- Dallon shportat ricikluese;
- Praktion një aktivitet.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Hapi 1:** Nxënësit udhëzohen të identifikojnë figurën e dhënë sipas ngjyrave:




- *Si quhen këto mjete?*

Përgjigje e mundshme: Quhen shporta ricikluese dhe janë të ndara sipas përbërjes së mbeturinave.

**Hapi 2:** Udhëzohen nxënësit të shikojnë në fotografi. Pyeten:

- *Çfarë tregon shporta me ngjyrë të verdhë?*



Ta mbajmë mjedisin të pastër!

Si do t'i ndash mbeturinat në tri shportat?

Shporta e verdhë: ____________________________

Shporta e kuqe: ______________________________

Shporta e kaltër: _____________________________

65

Përgjigje e mundshme: Në shportën me ngjyrë të verdhë, duhet të hidhen enët e metalit - kanaçet.

- *Çfarë tregon shporta me ngjyrë të kuqe?*

Përgjigje e mundshme: Në shportën me ngjyrë të kuqe, duhet të hidhen shishet e qelqit.

- *Po ajo me ngjyrë të kaltër?*

Përgjigje e mundshme: Në shportën me ngjyrë të kaltër, duhet të hidhen mbeturinat e letrave.

**Hapi 3:** Udhëzohen nxënësit që të dalin jashtë në oborrin e shkollës dhe të bëjnë mbledhjen e mbeturinave duke i klasifikuar në shportat përkatëse.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për dallimin e shportave dhe klasifikimin e mbeturinave nga oborri i shkollës.

**Detyrë:**

______________________________________________

______________________________________________

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:* ______________________________

______________________________________________

## Mësimi 72

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II
**Tema:** Kujdesi për mjedisin

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Diskuton për faktorët e mjedisit të jashtëm që ndikojnë në rritjen dhe në zhvillimin e tij/saj.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:**II.4; IV.3; V.3,5; VI.2,5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.



*Faktorët që ndikojnë në zhvillimin tim*

Faktorët që ndikojnë në zhvillimin tim janë të shumtë. Ndër më të rëndësishmit janë: toka, uji, ajri. Pastërtia dhe mirëmbajtja e këtyre tre faktorëve ndikon në rritjen dhe zhvillimin tim si njeri.
Toka, uji dhe ajri duhet të jenë të pastër dhe të mirëmbahen nga njerëzit, duke mos i ndotur e dëmtuar.
Toka dhe uji ndoten kur njerëzit hedhin mbeturina të ndryshme, ndërsa ajri ndotet nga tymi i makinave, tymi i fabrikave etj.

Përveç njeriut, a dëmtohet edhe dikush tjetër nga mbeturinat që gjenden në tokë, ujë ose ajër?

Në tokë______________________________

Në ujë______________________________

Në ajër______________________________

66

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Faktorët që ndikojnë në zhvillimin tim

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Tregon se çfarë sheh në fotografinë e dhënë;
- Dallon faktorët që ndikojnë në zhvillimin tonë;
- Arsyeton fjalitë e dhëna.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Hapi 1:** Nxënësve u tregohet një fotografi dhe u kërkohet që me një fjali ta përmbledhin atë që shohin.




*Faktorët që ndikojnë në zhvillimin tim*

Faktorët që ndikojnë në zhvillimin tim janë të shumtë. Ndër më të rëndësishmit janë: toka, uji, ajri. Pastërtia dhe mirëmbajtja e këtyre tre faktorëve ndikon në rritjen dhe zhvillimin tim si njeri.
Toka, uji dhe ajri duhet të jenë të pastër dhe të mirëmbahen nga njerëzit, duke mos i ndotur e dëmtuar.
Toka dhe uji ndoten kur njerëzit hedhin mbeturina të ndryshme, ndërsa ajri ndotet nga tymi i makinave, tymi i fabrikave etj.

Përveç njeriut, a dëmtohet edhe dikush tjetër nga mbeturinat që gjenden në tokë, ujë ose ajër?

Në tokë__________________________________________

Në ujë__________________________________________

Në ajër__________________________________________

66

**Hapi 2:** Kërkohet nga nxënësit të dallojnë faktorët që ndikojnë në zhvillimin tonë. Pyeten:

Ku dallon uji nga ajri në zhvillimin tonë?
Përgjigje e mundshme: Uji është burim i domosdoshëm për jetë, ndërsa ajri për frymëmarrje.

**Hapi 3:** Fjalitë e lexuara nxënësit do t'i arsyetojnë duke dhënë veprime.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit do të vlerësohen për dallimin e faktorëve kryesorë dhe arsyetimin e fjalive të dhëna.

**Detyrë:**

________________________________________

________________________________________

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 73

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II
**Tema:** Kujdesi për mjedisin

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Zbaton rregullat elementare të mbajtjes pastër të mjedisit që e rrethon.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:**II.4; IV.3; V.3,5; VI.2,5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.


Mjedisi im i përshtatshëm

Mjedisi, në njëfarë mënyre, përfaqëson vetë njeriun dhe është pjesë e pandashme që nga lindja. Andaj njeriu, ngado që shkon, duhet ta ketë në kontroll pastërtinë rreth vetes, të jetë shumë i kujdesshëm për të dhe të bëjë sa më shumë gjelbërime, të mbjellë lule, parqe të bleruara dhe gjëra të tjera të mira për natyrën.
Mjedisi është shumë i rëndësishëm për njerëzit; nga ai fitojmë shëndetin.

67

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mjedisi im i përshtatshëm

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Flet për një mjedis më të pastër;
- Përshkruan veprimet e personazheve;
- Praktikon një aktivitet në oborrin e shkollës.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Pema.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Hapet diskutimi bashkë me nxënësit rreth një mjedisi më të përshtatshëm.
Diskutim rreth pyetjes:

- *Çfarë duhet të bëjmë që ta kemi një mjedis më të përshtatshëm?*

Përgjigje e mundshme: T'i largojmë mbeturinat, mos t'i hedhim vend e pa vend mbeturinat etj.

**Hapi 2:** Udhëzohen nxënësit që t'i shikojnë personazhet në libër dhe të përshkruajnë për veprimet e tyre.

- *Çfarë po bën vajza me një fidan në* dorë?



Mjedisi im i përshtatshëm

Mjedisi, në njëfarë mënyre, përfaqëson vetë njeriun dhe është pjesë e pandashme që nga lindja. Andaj njeriu, ngado që shkon, duhet ta ketë në kontroll pastërtinë rreth vetes, të jetë shumë i kujdesshëm për të dhe të bëjë sa më shumë gjelbërime, të mbjellë lule, parqe të bleruara dhe gjëra të tjera të mira për natyrën.
Mjedisi është shumë i rëndësishëm për njerëzit; nga ai fitojmë shëndetin.

67

Përgjigje e mundshme: Dëshiron ta mbjellë pemën për një vend më të gjelbëruar.

*- Po ky djali me tabelën në dorë, çka po na tregon?*
Përgjigje e mundshme: Duhet t'i riciklojmë mbeturinat.

*- Po ky djali tjetër me një kovë me ujë, çfarë po na tregon?*

Përgjigje e mundshme: Duhet t'i ujisim bimët.

**Hapi 3:** Nxënësit dalin në oborrin e shkollës dhe do ta mbjellin një fidan, për një mjedis më të pastër.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për përshkrimin e veprimeve të personazheve dhe pjesëmarrjen aktive në aktivitet.

**Detyrë:**

___

___

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 74

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Lënda:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** II
**Tema:** Kujdesi për mjedisin

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Diskuton për faktorët e mjedisit të jashtëm që ndikojnë në rritjen dhe në zhvillimin e tij/saj.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:II.4; IV.3; V.3,5; VI.2,5;**

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1



*Tetëkahore*

Gjej fjalët: *natyra, uji, toka, ajri, gjelbërim, lule, faktor, mjedis, zhvillim, i përshtatshëm, tym.*

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ZH | RR | A | I | J | P | O | U | K | M |
| V | U | L | U | L | E | D | B | O | Ë |
| I | J | A | J | L | S | N | L | O | SH |
| LL | I | T | B | O | LL | E | B | I | T |
| I | GJ | E | L | B | Ë | R | I | M | A |
| M | A | P | S | A | E | TH | B | N | T |
| M | T | F | A | K | T | O | R | Ë | SH |
| SH | K | Y | S | P | O | R | T | E | R |
| O | X | A | M | J | E | D | I | S | Ë |
| N | A | T | Y | R | A | J | R | I | P |
| T | O | K | A | A | J | R | I | P | I |

*Përfundim*

Përmes realizimit të punës së organizuar, zbatimit të teknikave, metodologjisë dhe pyetësorëve të ndryshëm gjatë mësimdhënies, mësuesi/ja do ta mbajë të zgjuar kureshtjen e nxënësve përgjatë gjithë procesit të të mësuarit. Mësuesi/ja, duke qenë në rolin e krijuesit, kujdestarit, motivuesit dhe gjykuesit, ndikon në mënyrë të drejpërdrejtë në ndihmesën për motivimin e tyre. Kështu, këto lojëra, të përshtatura me procesin mësimor dhe në koherencë me programin mësimor, do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në formësimin e shprehive për zhvillimin psiko-motorik, si dhe në zhvillimin e shkathtësive pararendëse në kronologji.

Këto aktivitete nxitin shprehitë dhe vlerat për mësim të qëndrueshëm përgjatë gjithë jetës. Në këtë mënyrë, te nxënësit nxitet funksionimi bio-fiziologjik, aftësia për kreativitet, si paraprirëse e zhvillimit të fantazisë, që është shkalla më e lartë e synuar, sipas "Hierarkisë së Bloom-it".

Autoret

68

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Tetëkahore

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan mënyrën e zgjidhjes së detyrës;
- Identifikon fjalët e kërkuara;
- Flet rreth fjalëve të gjetura.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, matematika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Hapi 1:** Udhëzohen nxënësit të vrojtojnë detyrën dhe të përshkruajnë mënyrën e zgjidhjes së saj. Pyeten:

Si mund t'i gjejmë fjalët e kërkuara?

Përgjigje e mundshme: Duke i rreshtuar shkronjat poshtë, lart, majtas, djathtas.



## Tetëkahore

Gjej fjalët: *natyra, uji, toka, ajri, gjelbërim, lule, faktor, mjedis, zhvillim, i përshtatshëm, tym.*

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ZH | RR | A | I | J | P | O | U | K | M |
| V | U | L | U | L | E | D | B | O | .Ë |
| I | J | A | J | L | S | N | L | O | SH |
| LL | I | T | B | O | LL | E | B | I | T |
| I | GJ | E | L | B | Ë | R | I | M | A |
| M | A | P | S | A | E | TH | B | N | T |
| M | T | F | A | K | T | O | R | Ë | SH |
| SH | K | Y | S | P | O | R | T | E | R |
| O | X | A | M | J | E | D | I | S | Ë |
| N | A | T | Y | R | A | J | R | I | P |
| **T** | **O** | **K** | **A** | **A** | **J** | **R** | **I** | **P** | **I** |

## Përfundim

Përmes realizimit të punës së organizuar, zbatimit të teknikave, metodologjisë dhe pyetësorëve të ndryshëm gjatë mësimdhënies, mësuesi/ja do ta mbajë të zgjuar kureshtjen e nxënësve përgjatë gjithë procesit të të mësuarit. Mësuesi/ja, duke qenë në rolin e krijuesit, kujdestarit, motivuesit dhe gjykuesit, ndikon në mënyrë të drejpërdrejtë në ndihmesën për motivimin e tyre. Kështu, këto lojëra, të përshtatura me procesin mësimor dhe në koherencë me programin mësimor, do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në formësimin e shprehive për zhvillimin psiko-motorik, si dhe në zhvillimin e shkathtësive pararendëse në kronologji.

Këto aktivitete nxitin shprehitë dhe vlerat për mësim të qëndrueshëm përgjatë gjithë jetës. Në këtë mënyrë, te nxënësit nxitet funksionimi bio-fiziologjik, aftësia për kreativitet, si paraprirëse e zhvillimit të fantazisë, që është shkalla më e lartë e synuar, sipas "Hierarkisë së Bloom-it".

Autoret

68

**Hapi 2:**
Udhëzohen nxënësit të identifikojnë fjalët e kërkuara sipas mënyrave të mësuara dhe ato duhet t'i rrumbullaksojnë.

**Hapi 3:**
U shpjegohet nxënësve që në këtë tabelë gjenden tre faktorët kryesorë që ndikojnë në zhvillimin tonë.

Udhëzohen nxënësit që t'i gjejnë faktorët.

*- Cilët janë ata tre faktorë që ndikojnë në zhvillimin tonë?*

Përgjigje e mundshme: Toka, uji, ajri.

Kërkohet nga nxënësit që pas gjetjes së fjalëve t'i shpjegojnë faktorët që ndikojnë në zhvillimin tonë.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit do të vlerësohen në identifikimin e fjalëve të kërkuara dhe diskutimin e fjalëve të gjetura.

**Detyrë:**

___

___

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

___